FORMULARI TIP I

Date: 17/2017

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; Aplikim për leje mjedisi të tipit A
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; Subjekti: "ALBPETROL SHA", NIPT: J82916500U
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Fier, FIER, Patos, PATOS, Lagjia "29 Korsi"
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; Nxjerrje dhe përpunim nafte në QPN Ballsh, QPN PATOS, ASHG PATOS, QASHING PATOS
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; Nuk ka
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, proçedurat dhe afatet që do të ndiqen; Agjencia Kombëtare e Mjedisit
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; **info@akm.go.al**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

(Dorina [illegible])

NIPT: K88304501J

KuLD shpk 2 www.kuld.al

Nr.kontakti

067 20 10000

Raport joteknik për zonën naftëmbajtëse

Për Qëndrat në shfrytëzim të Albpertol Sha në qarkun e Fierit.

7/13/2017
Kuld shpk
Dorina Topoviti

NIPT: K88304501J
KuLD shpk
2
www.kuld.al

Ky raport është hartuar nga Studio mjedisore **KULD Shpk**:

Nr liçense: LN-7295-01-2014

Kontakt:

Adresa: Zona Don Bosko, Rruga"Hajredin Shtini, Pallatet Ermira

Phone: +355 67 201 0000
E-mail: info@kuld.al
www.kuld.al

Dorina Topoviti

Qëllimi i studimit:

Ky studim ka për qëllim njerjen e lejeve për Albpetrol Sha për pikat:

1. Cakran-Mollaj, Fier QPN Ballsh
2. QASHNG Patos, Rrjet tubacionesh (Instalime) për transportin e naftës
3. QPN Patos, Patos-Marinëz, Fier
4. QPN Ballsh, Ballsh-Hekal, Fier
5. QSHGJ Patos, Funksionimi i Uzinës Mekanike Patos, Fier

Përshkrimi për secilën nga zërat:

1. Cakran-Mollaj, Fier QPN Ballsh

1	Sek. Cakran – Mollaj Grupi 3 Mollaj	E = 4385053.35 N = 4497565.48
2	Q 25	E = 4385204.03 N = 4497588.03
3	Q 59	E = 4385414.21 N = 4497906.44
4	Q 17	E = 4385449.81 N = 4497918.11



2. QASHNG Patos, Rrjet tubacionesh (Instalime) për transportin e naftës

Stacioni Nr.16\1 Ballsh		
1	Parku i rezervuarëve	N: 4497283.91 E: 4392803.54
Stacioni Usojë		
2	Parku i rezervuarëve	N: 4496479.21 E: 4393929.73
Stacioni Visokë		
3	Parku i rezervuarëve	N: 4502724.12 E: 4388665.65
Stacioni Zharrëz		
4	Parku i rezervuarëve	N: 4509799.31 E: 4387348.33
Stacioni Kuçovë		
5	Parku i rezervuarëve	N: 4520049.96 E: 4407950.32

Ballsh:

Stacioni Nr.16\1
Ballsh

Usojë:


Rruga E Usojës
Stacioni Usojë
Rruga E Usojës
Rruga E Usojës
E Usojës

Visokë:



Zharrëz:

Kuçovë:



3. QPN Patos, Patos-Marinëz, Fier

Nr rendor	Vendi i matjes	Koordinatat
QPN Patos - Loti 5		
1	Dekantimi Visoke	E = 4386889.10 N = 4503540.35
2	Zharrez, grupi 490	E = 4386617.38 N = 4508920.48
3	Zharrez, grupi 9	E = 4387227.76 N = 4507475.26
4	Zharrez, grupi 7 Dukas	E = 4384710.87 N = 4505361.97
5	Zharrez 4 depo per monitorim	E = 4386673.15 N = 4509879.96
6	Sektori V-depot pritese , oficine	E = 4386881.06 N = 4503530.13
7	Stacioni 8, Patos – pike e re	E = 4384016.79 N = 4506608.24
8	Kompresoret e gazit Drenove, QTG Patos	E = 4390767.11 N = 4496384.03


QPN Patos Zharrez 4
5
SH73
QPN Patos
Zharrez, grupi 490
2
Zharrëz
Verbas
SH73
SH73
SH73
QPN Patos
Zharrez, grupi 9
3
Patos
7
DUKAS
Rruga Unaze
QPN Patos St.8
DUKAS
QPN Patos Zharrez,
grupi 7 Dukas
QPN Patos Sektori
V-depo Pritese
6
8
QPN Patos
Google

Kompresoret e gazit Drenove, QTG Patos

4. QPN Ballsh, Ballsh-Hekal, Fier

Nr rendor	Vendi i matjes	Koordinata Gauss Kruger
	QPN Ballsh - Loti 2	
1	Dekantimi Kash	N = 4495220.50 E = 4393765.56
2	Grupi Nr 1 Kojlac	E = 4393028.17 N = 4497092.85
3	Grupi Nr 4 Hekal	E = 4392557.34 N = 4492917.42
4	Karbunara 14, zona e prodhimit	E = 4391053.12 N = 4486062.48


Bar Hajriu
Grupi Nr 1 Kollac
Balish
Usoj
Dekantimi Kash
Grupi Nr 4 Hekal
Hekal
Pusi Bs-175
Parku Arkeologjik Bylis

Karbunara 14, zona e prodhimit

5. QSHGJ Patos, Funksionimi i Uzinës Mekanike Patos, Fier

E = 4384251.26, N = 4506526.13

Uzina Mekanike Patos

Fusha naftembajtese e Zonës së Fierit

Eshte nje nga fushat me te medha ne Europe sa i takon rezervave te naftes ne brendesi te kontinentit. Fusha qe perfshin nje siperfaqe prej rreth 160 km2 u zbulua fillimisht ne vitet 1928 dhe qe atehere eshte shfrytezuar me ritme dhe teknologji te ndryshme. Ky shfrytezim rreth 80 vjecar i fushes ka patur perfitimet e tij ekonomike por gjithashtu ka shkaktuar edhe nje gjendje te papershtatshme mjedisore qe verehet dukshem ne terren. Rritja e ndergjegjes shoqerore dhe krijimi i institucioneve mjedisore Shqiptare nuk mund te lene pa zgjidhur kete problem historik mjedisor i cili paraqitet ne kontradikte te plote me standartet mjedisore dhe aspiratat te vendit i cili eshte ne proces integrues.
Ne kuader te perpjekjeve te Qeverise Shqipetare per te realizuar nje nderyhrje te integruar per rehabilitimin mjedisor te fushes naftembajtese Patos-Marinze, Komisioni Europian financoi nje projekt qe perfundoi ne vitin 2008 i cili kishte dy qellime kryesore:

- Vleresimin e gjendjes mjedisore dhe shendetsore te zones
- Hartimin e planit te veprimit mjedisor dhe shendetsor per zonen;

Zhvillimi aktual dhe zhvillimi ne te ardhme i rajonit: Zona e studimit pershfin fushen naftembajtese te qarkut të Fierit, pikërisht **Cakran-Mollaj, Patos-Marinëz** dhe **Ballsh-Hekal** baseni tokesor me i madh naftembajtes ne Europe, me nje rezerve prej 7.7 miliarde fuci nafte. Aktivitet lidhur me industrine e hidrokarbureve kane rreth 80 vite qe ndodhin ne kete rajon

Aktualisht dy jane kompanite qe operojne ne kete fushe brenda zones se studimit:

- Bankers Petroleum Albania(Dege e Huaj), puset dhe infrastruktura e te cilit eshte e perqendruar e pjesen qendrore te zones ne studim;
- Albpetrol.Sh.a, ku puset dhe infrastruktura e te cilit eshte e pozicionuar ne jug te zones se studimit.

Qarku Fier

Kjo zone eshte nje zone fushore me ngritje te lehta kodrinore. Rreth 30 % te saj e perbejne kodrat. Veprimtaria per shfrytezimin e vendburimit ka nisur afro 50 vjet me pare nga ndermarrja shteterore e Marinzes e asaj kohe dhe qe ka vazhduar edhe ne ditet tona nga filiali me te njejtin emer i kompanise shteterore Albpetrol.Sh.a. si dhe vete operatori Bankers Petroleum Albania(Dege e Huaj) nga viti 2004.

Fusha naftëmbajtëse e pikërisht **Cakran-Mollaj, Patos-Marinëz** dhe **Ballsh-Hekal** ndodhet në Shqipërinë jug qëndrore dhe u zbulua në vitin 1928. dhe është një nga fushat e naftës më të mëdha në tokë në Evropën kontinentale.

Prodhimi i parë komercial u realizua nga pjesa jugore e fushës (Patos) në vitet 1930. Që nga ajo kohë, më shumë se 2 400 puse jane shpuar në fushën e Patos- Marinzës me thellësi që varion nga më pak se 300 m në më shumë se 1,900 m, dhe me thellësinë që vjen në rritje nga jugu në veri. Shumë prej këtyre puseve janë aktualisht jo ne shfrytëzim dhe një numër akoma më i madh prodhojnë në nivele shumë të ulëta marxhinale. Puset përmbajnë pako me rërë të vendosur në stivë në një interval të përgjithshëm prej rreth 250 m, nga zona e cekët në Goran në zonat e thella të Marinzës, dhe shumica e rezervave të naftës ndodhen në zonat e Drizës në qender. Prodhim ka pasur edhe nga zona gelqerore e Visokës e cila ka edhe rërë.

Megjithëse fusha e Patos-Marinzes ka prodhuar tashmë mbi 120 milionë fuçi naftë gjatë historisë së saj 70 vjeçare, ajo ka potencial që të vazhdojë të jetë një prodhues i rëndësishëm për shumë vite në të ardhmen. Kapaciteti i nxjerrjes se naftes ne ditet e sotme nga Bankers eshte rreth 15 000 barrela ne dite.

Figure 3: paraqitja skematike e vendburimeve naftegazit dhe rrjetit te tubacioneve

Pjesa tjeter e puseve aktive gjenden ne Zharrez e Sheqishte. Situata egzistuese e puseve te naftes duke perfshire dhe ato te Albpetrol.Sh.a eshte si vijon.

Puset e Albpetrol: jane te perqendruara me shume ne pjesen jugore te zones se studimit (afer Gjanices)

Ne vijim po prezantojme gjithe situaten e puseve, facilitteve te industrise hidrokarbure dhe infrastruktura e nevojshme , me siperfaqet perkatese qe ajo ze .

Ndërtimi gjeologjik i vendburimit naftegazmbajtese Patos - Marinzë

sipërmarrje "prodhimi". Patosi në jug është zona më e madhe dhe përfshin seksionet më të cekëta të formacioneve Driza dhe Goran. Ndërmarrja e Marinzës në veri ka prodhimin më të lartë, shumica e tij nga formacioni i Marinzës. Sheqishta në perëndim është më i fundit. Patos-Marinza ka rreth 7.7.miliardë fuçi naftë të rëndë, në vend-(OOIP-Original-Oil- In-Place (OOIP).
Fusha e Patosit u zbulua në vitin 1928 nga APOC (Anglo Persian Oil Company) dhe fusha e Marinzës (e cila pjesërisht kufizon fushën Patos) u zbulua në vitin 1957. Prodhimi ka filluar në vitin 1939. Zhvillimi ka ecur në përgjithësi në drejtimin nga zonat e cekëta jugore drejt kontakteve të naftë-uji në veri.

Deri më sot, janë shpuar rreth 2400 puse vertikalë. Është vlerësuar se deri më sot janë prodhuar rreth 120 MMbbl, dhe me prodhimin e pikut rreth 20.000 bopd në vitin 1957. Prodhimi aktual është e vlerësuar në 5,200 bopd nga rreth 750 puse aktive (prodhimi i Saxon është i përfshirë).

Zonat e rezervuarit janë shtresa të shumëfishta ranoresh të moshës së Miocenit të Sipërm (Mesiniane) që janë depozituar si depozitime detare të cekëta dhe paketa ranoresh. Formacioni më i thellë ,me interes është ai Marinzes, që përmban naftë më të lehtë, i pranishëm në pjesën veriore të zonës së zhvillimit. Mbi formacionin e Marinzes, ndodhet formacioni Driza që përmban nafte të rëndë, dhe përmban shumicën e rezervave. Ai është i pranishëm në të gjithë fushën. Pjesa e sipërme e formacionit Driza është e vështirë për tu dalluar nga farmacioni Gorani që ndodhet mbi të, i cili përmban rezerva shtesë kryesisht në pjesën jugore të fushës dhe në ranore bituminoze që dalin në fundin jugor të fushës. Zonat me interes ekonomik ndodhen gjatë një intervali prej rreth 250 m dhe kanë përmbajtje shumë të lartë rëre. Prodhim merret edhe nga karbonatet e copëzuara të Paleocen-Eocenit (formacioni Visoka) që ndodhen më poshtë, dhe prodhimi është nën nivelin e pajtueshmerise.
Fusha e Patos-Marinzes është një monoklinal, që ka nje renie 8-13°, në veriperëndim. Formacionet dalin në sipërfaqe në jug dhe kalojnë 1800m në thellësi në veri. Një mbivendosje me tendencë në veri formon kufirin verilindor të fushës. Brenda fushës, mekanizmi i mbajtjes së naftës ndryshon disi nga rëra në rërë, por kryesisht është kontakti naftë-ujë në veriperëndim, thyerjet në perëndim dhe verilindje, dhe zhveshjet gjeologjike te depozitimeve dhe thyerjet në lindje dhe jug.

Fusha ka qenë e ndarë në një numër sektoresh për qëllime të vlerësimit të naftës në venddhe rezervave, si dhe për përcaktimin e ri-zhvillimit të zonave. Këto ndarje kufizohen në pjesën kryesore nga thyerjet jug-perëndim dhe thyerjet nëntokësore veri- jug.
Zona Patos-Marinze eshte nje nga zonat me te rendesishme naftembajtese te
[illegible] kesaj zone eshte qyteti i Patosit, me 22.282

vendburimesh te naftes si Patosi,Marinza, Bubullima,Zharreza etj.Te gjitha fshatrat jane te lidhura me rruge dytesore te asfaltuara.Populsia merret me bujqesi, blegtori,ne baxhot e qumeshtit, e vetpunesuar ne sektorin privat kryesisht ate te sherbimeve si servise , tregti ,ne punishtet e prodhimit te vajit te ullirit, etj dhe pjeserisht eshte e punesuar ne puset e shfrytezimit te naftes.. Relievi i zones eshte fushoro-kodrinor. Zona fushore ze pjesen qendrore dhe veriore te zones ,ndersa zona kodrinore ze pjesen jugore dhe pak pjesen veri perendimore te zones .Kuota me e larte eshte maja e Margllicit 320.0m.Klima eshte mesdhetare .Temperatura mesatare vjetore eshte 14-15 grade C.

Zona pershkohet nga lumenjte e Gjanices dhe te Semanit.Lumi i Gjanices eshte i gjate 67 km.ne territorin e zones Patos-Marinze eshte i pranishem per 12,5 km.Ai eshte lumi me i ndotur ne Shqiperi.,eshte i tipit torrencialsepse ushqehet nga ujrat siperfaqesore (69%). Lumi Seman eshte formuar nga bashkimi i lumenjeve Devoll dhe Osum , qe takohen ne afersi te Kucoves .Pellgu ujembledhes i Semanit eshte shume i rendesishem persa i takon rezervave te ujrave nentoksore ,sidomos ne rajonin Berat-Kucove -Fier..Ai ka luajtur nje rol te rendesishem ne gjeomorfologjine e rajonit.Lumi ka gjatesi 281 km, dhe geresi mesatare rreth 20.0 m.

Naftembajtja

Në zonën e pikërisht **Cakran-Mollaj, Patos-Marinëz** dhe **Ballsh-Hekal**, depozitimet e Tortonianit dhe Mesinianit u depozituan në mjedisin sedimentar detar të cekët, të një pellgu të ulët. Ekzistojnë 5 formacione ranore naftëmbajtëse të Tortorian-Mesinianit: Bubullima, Marinza (1 & 2), Driza, Gorani dheKucova të mbihypura nga depozitimet ujë-mbajtëse të formacioneve të Polovinës, Helmesit dhe Rrogozhinës. Një shembje e periudhës së Tortonianit mbihypet në mënyrë progresive nga Bubullima, Marinza dhe Driza nga fundi në krye dhe, përgjithësisht, nga veriu në jug. Kjo shembje nxjerr sipër gëlqerorët, flishin dhe mergelet argjilore të Paleogjenit dhe Kretakut. Zonat e shfrytëzimit ndeshen në një interval prej rreth 250 m dhe kanë përmbajtje të lartë rëre. Gjithashtu, prodhimi vjen edhe nga gelqeroret copezore të Palaeocen -Eocenit të cilat ndodhen më poshtë (formacioni Visoka), nën nivelin e shembjeve. Nga zonat më sipërfaqësore tek ato më të thella, stratigrafia permblidhet përgjithësisht si ne tabelen e meposhtme:

Burimi

Nga pikëpamja rajonale, shiste të pasura me lëndë organike dhe karbonate të Triasikut të Sipërm, Jurasikut të Poshtëm dhe Kretakut të Sipërm u depozituan në mjedise të kufizuara detare në kufirin jugor të pllakës Europiane. Këto formacione u varrosën dhe [illegible] dhe prodhuan hidrokarburet e zbuluara në disa fusha

nafte të lidhura me gazin e lëngshëm në Shqipëri.
Në kahun jugor të Ultesires Adriatike, nafta u krijua nga shëmbinjtë burimorë të Jurasikut të Poshtëm dhe të Mesëm dhe migroi përgjatë zonave të shkara dhe atyre poroze të gëlqerorëve të Visokës dhe përmes shembjeve, në sedimentet e sipërndodhura. Nuk ka të ngjarë që migrimi të ndodhë në shtresën e flishit, e cila ndodhet sipër gëlqerorëve pasi ai formon mbulesen për këta gëlqerorë, në fusha tjera në jug. Migrimi nga veriu përmes Bubullimës duket i pamundur pasi në atë drejtim gjendet ujë dhe nuk tregon për mbetje hidrokarburesh.

Ranoret Bituminoze

Ranoret bituminoze jane mjaft te perhapur ne zonen e Patosit dhe te Kasnices. Vendburimi i ranoreve bituminoze , perfshihet ne strukturen monoklinale te Patosit , te perbere kryesisht nga depozitime te Mesinianit , qe vendosen transgresivisht mbi depozitimet me te vjetra dhe kontaktojne ne disa vende me strukturen karbonatike te Patos-Verbasit.Ky monoklinal ndertohet ne teresi nga disa shtresa ranoresh te nderthurur me argjilo-alevrolite , te ngrupuara ne disa suita apo formacione , qe nga poshte lart jane emertuar : Bubullima, Marinza, Driza, Gorani, Polovina-Kucova.renia e tyre eshte 10-15 grade ne drejtim te veri-perendimit.
Ne kete vendburim jane llogaritur 157 milion ton rezerva industriale dhe gjeologjike si dhe 380 milion ton rezerva prognoze.Permbajtja e bitumit eshte mesatarisht 8%, pike-zbutja 22-48 grade.

Jane ndeshur 6 horizonte .Tre ne formacionin Driza dhe tre te tjera ne formacionin Gorani. Analiza kimike e bitumit eshte : S-5.85%, H-4.0%, C-72.71%, N-1.22%, O- 0.002%, Lageshtia 5.0% dhe hiri 11.2% Deri ne vitin 1984 jane shfrytezuar dhe perpunuar me sukses. Per rezervat e mbetura lypset nje teknologji me efikase per ta vene ne eficience kete pasuri te madhe.

KAPITULLI IV



Pershkrimi I Mjedisit

Nga pikpamja fitoklimatike rajoni i studimit shtrihet në Brezin e pyjeve dhe shkorreteve mesdhetare dhe karakterizohet nga nje diversitet habitatesh dhe komunitetesh bimore, te tilla si vegjetacion i shtretërve të lumenjve, ligatinor i ujrave të embla ose te stadeve te ndryshme te degradimit të tyre, natyrore, gjysem natyrore dhe artificiale apo të krijuar nga aktiviteti njerezor.

Rrethi i Fierit është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Fierit. Rrethi i Fierit ka 200,000 banorë (sipas 2004), një sipërfaqe prej 850 km^2 dhe kryeqendër Fierin.

Fieri është qytet në Shqipërinë e jugut. Fieri ndodhet në jug të rrethit të Lushnjës, në perëndim të rrethit të Beratit, kufizohet gjithashtu në jug me Vlorën dhe në juglindje me rrethin e Mallakastrës, rreth i cili para ndarjeve të reja administrative të viteve '90 bënte pjesë gjithashtu në përbërjen e rrethit të Fierit. Përsa i përket qytetit të Fierit popullsia e tij pas viteve '90 të shekullit të XX numëronte 40 000 banorë, kurse në ditët e sotme, si rezultat i dyndjes së popullsisë nga rrethi i Mallakastrës dhe nga rrethet veriore të vendit, vlerësohet që popullsia e qytetit të Fierit të ketë arritur në 85 000 banorë.

Karakteristikat e pergjitheshme te mjedisit natyror

Rrethi i Fierit ofron dhe potenciale te rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Ne

detit dhe me toka shumë pjellore.Edhe relievet kodrinore janë pergjithesisht te buta dhe te mundshme për shfrytezim bujqesor.Ne zonat e rrafsheta zhvillohen tokat e hirta kafe.

Kemi edhe lloje te veçanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjoses, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat mocalishte te Roskovecit. Ne rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqese se Madhe, Myzeqeja e Vogel dhe fushat e Frakulles e te Cakranit. Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë ne brezin e klimes mesdhetare, dhe dallohet për tipare me te shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim të madh te diellit dhe dimeri i bute dhe me rreshje te mëdha. Ngricat dhe debora janë dukuri tepër te rralla. I nxehti fillon qysh nga mesi i pranveres dhe vazhdon deri në fund te tetorit. Klima e Fierit është e ngrohte sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej ererave te ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë te ditëve me diell mesatarisht 2800 ore ne vit.

Rreshjet kanë rregjim kohor shumë te crregullt ato janë perqendruar kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit,sasia mesatare e tyre arrin 980-1000mm/vit. Vera ne Fier është e thate dhe shpesh nuk bie shi për jave te tera. Muajt me te lagesht janë nentori dhe janari, kurse muajt me te thate korriku dhe gushti. Ererat fryjne ne drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje te mëdha, ndërsa gjatë veres era fryn nga veriu dhe veriperendimi. Afersia me detin bën qe klima te jetë e bute dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat te bien nën zero.

Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 150C-160C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqesie shumë degeshe. Gjithashtu tokat bujqesore mund te shfrytezohen 2-3 here ne vit. Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi te veçantë kanë pasurite ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi pershkohet nga lumenjte Seman, Vjose e Gjanica. Semani -281 km i gjatë formohet nga bashkimi I Devollit me Osumin ne afersi te Beratit. Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 5949 km2, prurja mesatare vjetore e tij arrin ne 96 m3/sek.Semani është nder lumenjte me eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjose - 272 km I gjatë buron nga malet e Pindit ne Greqi.Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 6700 km2,ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m3/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Pocemit e te Kalivacit.Siperfaqj a e pellgut ujembledhes është 234 km2. Është një nga lumenjte me te ndotur në vend, për shkak te derdhjes se naftes. Rrethi ka dhe disa liqene artificiale ku me I madhi e me I rendesishmi prej tyre është ai I Kurjanit me siperfaqe 375 ha, ujerat e tij përdoren për ujitje.

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e

dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjsh. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi I Fierit bën pjes ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies,ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina.

Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel. Nentoka është mjaft e pasur me lende djegese siç janë gazi natyror dhe nafta ku dallohet zona e Patos-Marinzes, e cila është dhe zona naftembajtese me e madhe ne Shqipëri. Gjithashtu nenetoka është e pasur dhe me materiale ndërtimi si zhavore, rerera, argjila etj.

Rrethi I Fierit është një nga rrethet ku shoqëria njerëzore ka demtuar botën e gjallë, si dhe me ndotjen mjaft te madhe te ajrit.Ne te bëjnë pjesë disa zona te nxehta mjedisore si : fusha naftenxjerrese Marinez-Patos, Rafineria e Naftes Ballsh, AZOTIKU. Këto zona kanë sjelle ndotjen e dy lumenjve Gjanica dhe Seman, ujerave nentokesore dhe ne kombinim me automjetet e transportit,qe clirojne një numer të madh gazrash, pluhuri dhe bloze, si dhe kanë bërë qe Fieri te këtë edhe një ajër tepër te ndotur mbi normat e lejuara. Një nga problemet kryesore është edhe eleminimi I 850 m3 me tretesire arseniti dhe arsenati tepër helmues qe ndodhen ne Uzinen e Plehrave Azotike.

Tipi i abitateve dhe flora e tyre

Tokat bujqësore të punueshme, të degraduara dhe ato të abondonuara zenë afërsisht më shumë se gjysmën e sipërfaqes së rajonit të studimit. Në këto mjedise biodiversiteti është dëmtuar më shumë se në të gjithe ekosistemet e tjera.
Plugimet e perseritura të këtyre tokave dhe pa masa mbrojtese kane çuar deri në dëmtime të përmasave të pandreqshme dhe aktualisht një pjesë e madhe e sipërfaqes të tokave bujqësore janë abondonuar. Ato fizikisht jane gerryer në përmasa të medha dhe në shume raste ka dale në siperfaqe tabani shkëmbor. Në të gjithe këtë zonë vetëm rrallë mund të shohësh copëza vegjetacioni natyral të dominuara nga Phlomis fruticosa, rrallëherë nga Quercus coccifera, Spartium junceum. Më shpesh vihen re sipërfaqe të konsiderueshme të mbuluara nga Rubus ulmifolius (ferra) dhe Paliurus spina-christi (driza). Tregues të tjere të ketij degradimi jane perhapja ne nje shkalle te konsiderueshme e specieve te tilla si species invazive Dittrichia viscosa, dhe llojeve antropogjene Asphodelus aestivus, Andropogon ischaemum, Erigeron canadensis,etj.

Flora e tokave bujqësore eshtë e varfër në lloje dhe monotone. Në habitate të tilla perfshihen shume hapësira të zonës fushore e kodrinore, të cilat janë të ekspozuara ndaj

ulet dhe ato jane direkt te kercenuara nga veprimtaria e njeriut. Nga flora kriptogamike në këto habitate rritet rreth 1 % e numrit total te specieve. Kuptohet qe ne tokat e punuara, biodiversiteti bie ne menyre te ndjeshme, sidomos kur perdoren herbicidet.

Nga familjet fanerogamike me shkallë më të lartë përhapjeje dhe me një numër më të madh llojesh janë: Asteraceae, Poaceae, Fabaceae, Cruciferae, Papaveraceae, Charyophyllaceae, Polygonaceae, Convolvulaceae dhe Primulaceae. Speciet me frekuencë dhe sasi më të lartë në rreth 60% te rilevimeve janë Dittrichia viscosa, Papaver rhoeas apo lulkuqja dhe me pas do te përmendnim: Avena sterilis, Lactuca seriola, Alopecurus myosuroides, Sinapis arvensis, Capsella bursa-pastoris, Sonchus vulgaris, Anagallis arvensis, Medicago lupulina etj.

Tokat e abandonuara, dikur të zëna me kultura bujqësore dhe më pas të braktisura për arsye të ndryshme (të përfituara kryesisht nga shpyllëzimet e të kultivuara për disa vjet, tani tërësisht të eroduara e pa pjellori) mbulojnë një sipërfaqe të konsiderueshme në këtë rajon dhe karakterizohen nga një florë e varfër dhe monotone, e cila gradualisht me kalimin e kohës mund të marrë pamjen e saj natyrore. Vrojtimet e bëra në këto terrene tregojne se mbulesa bimore varion, mbi të gjitha, në relacion me kulturën e fundit te praktikuar. Në krahasim me florën e terreneve të kultivuara, në terrenet e abandonuara, për një periudhë të shkurtër, më dominuese janë: Calystegia sepium, Daucus carota, Erigeron epiroticus, Conyza canadensis, Lactuca seriola.

Duhet theksuar fakti se bimësia spontane e terreneve të abandonuara e të lena djerr përbën një burim infeksioni për terrenet e kultivuara në afërsi të tyre.
Vrojtimet tregojnë se terrenet e abandonuara, te paprekura e të pa shqetësuara nga veprimtaria humane, në rajonet kodrinore në jug të rajonit të studimit e veçanërisht në krahinën e Ballshit, evoluojnë drejt pyllit primitiv me specie dominante ilqen(Quercus ilex). Specie të tilla si Rubus fruticosus, Rosa canina, Rosa sempervirens, Juniperus oxycedrus, Spartium junceum, Quercus pubescens etj., me një regjim paprekshmërie të një periudhe 10 – 15 vjeçare janë një premisë për rehabilitimin e këtyre mjediseve drejt formacioneve pyjore apo brezit të pyjeve dhe shkorreteve mesdhetare. Nga kjo mund te arrihet ne konkluzionin se ne kushte te tilla, ne alternativë me nje pyllezim artificial, shumë të kushtueshëm, me specie ekzotike dhe të vështira për t'u adaptuar, duhet menduar për një evolucion natyror të vegjetacionit, që në përfundim pak më të gjate, por të sigurt, do të shkonte drejt nje formacioni pyjor natyror dhe në harmoni me fizionominë e pejsazhit të qendrueshem. Megjithate peizazhi, evoluimi i tij duhet te ndiqet hap pas hapi, sepse mund te ndodhe procesi i kundert. Tokat e abandonuara mund te perfshihen nga erozioni intensiv dhe per pasoje ato do te degradohen me tej deri ne shkretim te plote. Në këtë rast duhet të nderhyhet me pyllëzime artificiale.

Rehabilitimi i ketyre terreneve, do kerkonte nje nderhyrje te kujdesshme, duke respektuar stadet e degradimit vegjetacional. Kjo do te kerkonte pike se pari mbjelljen e esencave pyjore pioniere te pershtatshme, ne perputhje me stadin ku duam te arrijmë.

P.sh. ne stade te avancuara te degradimit, si ne rastet e mesiperme, do ishte e domosdoshme mbjellja e esencave te tilla si: Juniperus oxycedrus, Fraxinus ornus, Carpinus betulus, Carpinus orientalis, Phillyrea latifolia, Phyllirea angustifolia, Erica arborea, Arbutus unedo, Quercus trojana etj.

Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare

Pjesa jugore e rajonit të studimit ku përfshihen kodrat përreth qytetit të Patosit, Ballshit dhe një pjese të krahinës së Mallakastrës përfaqësohet nga një zonë kodrinore pjesërisht e mbuluar nga një bimësi natyrore dhe që i përket stadeve të ndryshme të degradimit të pyjeve përherëblertë mesdhetarë dhe pjesërisht të shpyllëzuara dhe të transformuara në vreshta apo ullishte.

Në ditët e sotme në këtë brez si rezultat i aktivitetit të fuqishem human, prerjet, kullotja intensive, zjarret e shpyllëzimet me qëllim përfitimin e tokave për kultivimin e bimëve të kulturës, kanë mbetur shumë pak bashkësi bimore natyrore në kuptimin e ngushtë të ketij nocioni. Krahas dëmtimeve të mësipërme një faktor tjetër me pasoja shumë të demshme për këto zona përfaqëson dhe erozioni i tokes. Në disa vende toka është bërë kaq e eroduar saqe shkembi amnor pothuajse i zhveshur pranon vetem bashkesi barishtore te nderprera te tipit stepik te perbera nga kortezhe te pasura floristike e interesante dhe me lulëzim pranveror.

Bashkesitë natyrore e gjysem natyrore në këtë rajon sot, kanë një shtrirje fragmentare, përgjithësisht ne vende te veshtira per t'u arritur nga njeriu dhe kafshët dhe dominohen pergjithesisht nga specie drunore perhereblerta, shkurre e gjysemshkurre qe mund te jetojne per nje kohe te gjate ne mot te nxehte e pa shi. Shume nga speciet drunore kane gjethe te vogla e te modifikuara per reduktim te transpirimit gjate thatesirave verore. Shume jane aromatike, te pasura me vajra eterike, te afta te reduktojne humbjen e ujit dhe demtimet nga kullotja. ilex), janë zhdukur pothuajse totalisht. Ai eshte ruajtur vetem në disa mikrohabitate te kufizuara e fragmentuara dhe larg qendrave të banuara. Formon pyll te hapur me drurë të larguar, për pasoje me kat shkurror dhe barishtor te zhvilluar mire.

Kati shkuror mund te jete i larte deri 3 m. Shkurret me karakteristike jane: Pistacia lentiscus, P. terebinthus, Rosa sempervirens, Cercis siliquastrum, Rhamnus alaternus, Hedera helix, Arbutus unedo, Phyllirea angustifolia, Ph. latifolia, Viburnum tinus, Lonicera etrusca, L.

implexa, Cistus incanus, Daphne gnidium, Myrtus communis, Coronilla emerus etj.
Ne katin barishtor me shpesh dallohen Euphorbia characias, Teucrium chamaedrys, Stachys officinalis, Rubia peregrina, Asparagus acutifolius, Ruscus aculeatus, Aspleniumadianthum-nigrum, Symphytum tuberosum, Dorycnium hirsutum, Cerinthe major etj.

Por më shpesh bimësia e këtyre mjediseve perfaqesohet nga stade të ndryshme të degradimit të pyjeve primitive te dikurshem të dominuar nga ilqja (Quercus ilex). Më shpesh në këto mjedise vihen re formacione shkurrore të dominuar nga pralli (Quercus coccifera). Konsiderohet si element i degradimit të formacioneve klimaks të ilqes, per shkak te mbishfrytezimeve, kullotjes intensive e pa kriter dhe zjarreve. Areali i tij, dikur i vazhduar, eshte mjaft i fragmentuar edhe per shkak te aktivitetit bujqesor, shpyllezimeve, kryesisht për qëllime të kultivimit të kultures se ullirit e vreshtave. Speciet me karakteristike te ketij shoqerimi jane: Pyrus amygdaliformis, Phlomis fruticosa, Phillyrea latifolia, Pistacia terebinthus, P. lentiscus, Euphorbia characias, Hypericum perfoliatum, Cistus incanus, etj. Në shumicën e rasteve ky formacion paraqitet me një shkallë degradimi shumë të lartë duke u shndërruar në vegjetacionin e të ashtuquajturave "Gariga". Garigat përfaqësojnë një vegjetacion pak a shumë të hapur, të dominuar nga Quercus coccifera e disa lloje të tjera shkurresh e shkurrëzash në gjendje shumë të degraduar, rreth 50 cm të larta dhe më rrallë deri 1 m, të shtrira e në trajtë gëmushore dhe të distancuara nga njera tjetra. Gjate verës pjesët e ekspozuara të këtyre shkurreve thahen, duke i dhene vegjetacionit nje aspekt "te djegur". Shume nga llojet përbërëse të këtyre formacioneve i përkasin grupit të llojeve aromatike, shpesh me gjethe të vogla e të trasha, me modifikime epidermike që reduktojnë humbjen e ujit nga temperaturat e larta të verës apo transpirimi. Disa janë te pangrënshme nga kafshet, te tjerat jane me shume gjemba.

Krahas stadit të dominuar nga pralli (Quercus coccifera) një stad tjetër degradimi i përhapur në këtë rajon është dhe ai i dominuar nga gjineshtra (Spartium junceum), që përfaqëson edhe specien dominante të ketyre mjediseve. Krahas kësaj specie, flora e saj përfaqesohet edhe nga specie të tilla si Phlomis fruticosus, Ruscus aculeatus, Asparagus acutifolius, Teucrium polium, Cistus incanus, Cistus salviafolius, Bellis perennis, Smilax aspera, Dactylis glomerata, Arum italicum, Anemone hortensis, Cynodon dactylon,Anthoxanthum odoratum, Briza maxima, Chrysopogon gryllus, Poa bulbosa, Micromeria juliana,Cynosurus echinatus dhe ngashkurret Pistacia lentiscus, Myrtus communis, Phillyrea angustifolia, Paliurus spina-christi, Pyrus amygdaliformis, Juniperus phoenicea etj.

Mbi këtë tip vegjetacioni ne kohen e sotme vihet re nje degradim i metejshem i saj si rezultat i djegjeve te herepashershme nga banoret e zones (barinjte) me qellim "permiresimin e kullotes dhe cilesise se barit" dhe kullotjes intensive. Treguesit kryesore te ketij

degradimi jane perhapja ne nje shkalle te konsiderueshme e specieve te tilla si Galactites tomentosa (specie gjembore), species invazive Dittrichia viscosa, dhe llojeve antropogjene Rubus ulmifolius, Pteridium aqualinum,Asphodelus aestivus, Andropogon ischaemum, etj. Shpesh herë në mbulesën e përgjithshme vihen re edhe copeza vegjetacioni te friganave (edhe keto forma degradimi te metejshem te "stepes mesdhetare") te dominuara nga Thymus capittatus, Anthyllis hermanniae, Phlomis fruticosus, etj.

Prania në sasira të konsiderueshme e species Spartium junceum tregon per nje intensitet te veprimtarise erodive ne keto shpate e shoqeruar kjo edhe me degradimin e tokes.

Bimësia në Shqipërinë e Përëndimit



PARQET

Emri i parkut (rrethi)	Sipërfaqja ne hektar	Sip. ne % ndaj sip. se pergjith
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]
Gjithsej	[illegible]	100%

Fauna

Në studimin tonë ne kemi kryer vëzhgime në teren gjatë disa ditëve ekspedita në muajt Shkurt 2016 – Korrik 2017, në këtë zonë të qarkut të Fierit. Ne kemi kalur në komunat Krutje, Bubullimë, Kolonjë të qytetit të Lushnjës, në komunat Libofshë, Mbrostar, Qëndër, Kuman, Marinzë, Zharrëz, Portëz, Ruzhdie të qytetit të Fierit, si dhe në rrethinat e qyteteve Patos, Roskovec, Cakran dhe Ballsh.
Kemi kryer analizim faunistik për lloje në habitate të ndryshme dhe përfaqësuese të zonës, e cila si një zonë me shtrrirje të gjerë përfshin si habitate fushore me bimësi natyrale, habitate fushore me kultura bujqësore të cilat ishin jo të pakta në zonë, në habitate të shkureve mesdhetare, habitate pyjore, habitatet me bimësi përreth shtretërve të lumenjëve (Seman, Gjanicë), përrenjëve (Zharrës, Aliut, etj), kanaleve apo pellgjeve ujëmblëdhës (Hoxharë, etj).

Për të arritur në përfundime sa më të sakta dhe shkencore për llojet faunistikë të zonës, ne kemi kryer vëzhgime të lira me sy gjatë ecjeve në ekspedita, gjatë ecjes kemi kryer vëzhgime me imëtsi duke ndaluar dhe vëzhguar me kujdes habitatet, si për të vëzhguar direkt lloje të faunës, ashtu edhe për të dalluar cfare do lloj shënje të lënë prej tyre, vëzhgime me dylbi, vëzhgime me sy të gjurmëve apo feceve. Kemi vëzhguar nën gurrë duke i lëvizur ato, në pemë, kemi kryer grumbullime për invertebrorë (insektet) duke përdorur rrjetat, ne habitate barishtore, anës lumenjëvem etj. Pjesën kryesore të tyre më përfaqësues e kemi përcaktuar direkt në terren kurse një pjesë e kemi transportuar në shishe të vogla plastike për ta përcaktuar më pas në laborator. Për të gjitha rastet kemi mbajtur shënime të qarta dhe të detajuara për emrin e llojit si dhe vendbanimin e takuar. Gjithashtu për të krrijuar një tablo më të qartë për faunën e kësaj zone, kemi pyetur banorë vendas që i kemi takuar në mënyrë rastësore, për lloje të kafshëve (faunës) që ata vetë kanë parrë ose dëgjuar për zonën e tyre, ose si/dhe për peshq të lumenjëve, kanaleve dhe pellgjeve ujëmbledhës.

Gjatë ekspeditave kushtet e motit ishin optimale, koha ishte me diell dhe në ndonje moment kishte vranësira, por në asnjë rast nuk qëlloi kohë me shi. Temperatura ishte mesatarisht 16 – 21^{0}C, lartësia mbi nivelin e detit rreth 0 deri 320m. Terreni fushor lejonte vezhgime me sy të lirë në një distanë optimal rreth 3 – 4 km, kurse në terrene të thyera, në shkureta apo terrene me pjerësi distance e pamjes ishte më e kufizuar.
Kishte veshtirësi në ecje në terrene jo të përshtatshme, jo cdo pjese e fushave me kultura bujqëesore mund të lejohej të vëzhgohej lirrisht, vështirësi në ecjen pa ndërprje përgjatë të shtrateve lumore apo përrenjve dhe kanaleve ujëmbledhës, etj. Mendojmë së këto vështirësi nuk e cenojnë rezultatet e këtij vlerësimi faunistik për këtë zonë.

Të gjithë vezhgimet e kryera në terren, shënimet e mbajtura, etj, i kemi përpunuar dhe analizuar më pas në laborator, si dhe jemi konsultuar dhe me literaturë kryesore për faunën e

kësaj zone.

Nga vëzhgimi dhe a nalizimi na rezulton se përbërja faunistike apo biocenoza (tërrësia e kafshëve në një habitat-biotop të caktuar) e kësaj zone, përfshin lloje të gjitarëve (mammalofauna) dhe shpendëve (avifauna) shtëpiake, gjitarë për përdorim në bujqësi, faunë të egër (insekte, reptilë, gjitarë, shpendë) të fushave, shkureve dhe pyjeve mesdhetarë me gjelbrim të përhershëm, fauna e pyjeve, fauna (amfibë, peshq) të ujërave të embël të lumit, pellgjeve ujëmledhës, etj.

Duke kryer vëzhgime më sy të lirë, duke parë gjyrmë të gjitarëve, fece te tyre, si dhe duke pyetur banorë të zonës për kafshë që ata vetë kanë parë në zonën tyre. Kjo zonë edhe për shkak të habitateve të pakësur si pasoje e ndërtimeve të kësaj dekade, shtimit të zhurmave dhe shqetësimeve për gjaitarët si pasojë e industrisë, ndërtimeve të shumta të vilave të banit dhe ekonomive të ndryshme (bare, lavazh, etj), ka sjellë ulje të numrit të gjitarëvem dhe vështirësi subjektive në indentifikimin e tyre nga ekspeditat tona. Të zakonshëm në vëzhgim ishin gjitarët shtëpika dhe ata që përdoren në bujqësi.

Gjeologjia e rajonit

Ne kete zone dhe perreth jane takuar depozitimet e Serravalianit, Miocenit te Siperm(Mesinianit), Pliocenit (Formacioni "Helmesi" dhe Rrogozhina") si dhe depozitimet e Kuaternarit.

Depozitimet Serravaliane

Keto depozitime ndeshen ne pjesen jug-lindore te zones ,ne Kasnice dhe perfaqesohen nga nderthurje te argjilave masive ,me pako ranoresh masive.Ne shumicen e rasteve argjilat nuk kane shtresezim e as ndertim tekstural te qarte .Midis tyre jane takuar dhe nderthurje shtresash te gelqeroreve litotamnike. Trashesia e depozitimeve te Serravalianit luhatet nga 200-700 m.

Depozitimet e Miocenit te Siperm

Keto depozitime vendosen ne menyre transgresive mbi depozitimet me te vjetra te antiklinalit te Patos-Verbasit. Ato ndertojne pjesen jugore te monoklinalit te Patosit,nga kodrat e Krapsit,ne Visoke e deri ne Ruzhdie . Ndersa ne thellesi , keto depozitime jane takuar pothuajse ne te gjitha puset e shpuar per zbulimin e naftes dhe te gazit .Nga ana litologjike ekzistojne dy litofacie : litofacia ranoro – argjilore dhe litofacia gjipsmbajtese.

Litofacia argjilo-ranore perfaqesohet nga nderthurje paketash ranorike ,me paketa

kokerndryshem, me shtresezim te pjerret, rralle here me zaje te vegjel. Argjilat kane pamje me teper alevrolitore ,me ngjyre hiri .Midis tyre ndeshen disa horizonte makrofaunistike te tipit Ostrea, te dallueshme per largesi te medha. Litofacia gjipsmbajtese,kudo perfaqesohet nga argjila e alevrolite te nderthurura me gjipse shtrese trashe.Midis tyre ndeshen dhe shtresa te rralla ranoresh.Gjipset kane perhapje ne trajte linzash , me trashesi deri ne disa metra.Trashesia e depozitimeve te Mesinianit luhatet nga 200-2000 m.

Eshte per tu theksuar se me depozitimet e Miocenit te Siperm jane te lidhura te gjitha suitat naftembajtese:Bubullima, Marinza, Driza, Gorani, Polovina-Kucova si dhe nje sere shtresash ranoresh bituminoze qe perbejne nje objekt te rendesishem industrial.

Depozitimet e Pliocenit.

Ne zonen e studjuar prej nesh, depozitimet e Pliocenit, ndeshen ne veri te lumit Gjanica dhe ne juge te Patosit, ne Kuqan, Shpataj, Zharrez dhe ne Kolonje. Nga ana litologjike keto depozitime perfaqesohen nga dy pako me karakteristika te vecanta ,te njohura si formacioni"Helmesi" dha ai "Rrogozhina",duke ruajtur nje suksesivitet normal midis tyre. Depozitimet e formacionit "Helmesi" jane ndeshur ne zonen tone, ne veri te lumit Gjanica dhe ne juge te Patosit(lumi Gjanica kalon pikerisht mes per mes depozitimeve pliocenike te formacionit"Helmesi"), si dhe pjeserisht ne pjesen veri-lindore te zones, ne Kolonje. Ato perfaqesohen nga shtresa ranore ,konglomerate te pangopur, qe shenojne pranine e transgresionit pliocenik dhe vijojne me shtresa argjilore dhe paketa argjiloranore. Ranoret jane shtresore, me trashesi te vogla. Argjilat jane mbizoteruese ne prerje, kane ngjyre hiri ne te kalter, jane te buta deri ne kompakte, here here shume mikore. Depozitimet e formacionit "Helmesi"takohen dhe ne thellesi nga puset e shpuar. Trashesia e tyre luhatet nga 500-1100 m. Depozitimet e formacionit "Rrogozhina"jane ndeshur ne kodrat e Zharrezes dhe ne Kolonje(pjesa veri-lindore e zones se studjuar).

Ne prerje ndeshen argjila shtresore, here here me pamje masive, qe shpesh nderthuren me paketa argjilo-ranore si dhe me ndershtresa alevrolitesh e ranoresh. Me rralle ndeshen shtresa te holla dhe thjerza merglore.

Depozitimet e formacionit "Rrogozhina" vendosen mbi pakon argjilore te formacionit "Helmesi"dhe kane marredhenie normale midis tyre. Keto depozitime kane karakter trashaman dhe perbehen nga ranore, gravelite, konglomerate, qe nderthuren me pako ranoresh, me trashesi 4-6 m.Ranoret jane koker vegjel deri ne koker trashe, shpesh gravelitike, poliminerale, te tipit kuarcoro feldshpatik me permbajtje serpentinash.

Ne konglomeratet ndeshen zaje te rrumbullakosura te shkembinjeve magmatike dhe sedimentare. Masa cimentuese e konglomerateve eshte argjilo-ranore ,gravelitike e tipit bazal. Trashesia e formacionit "Rrogozhina" ne prerjen e Patosit arrin ne 50-80 m, ndersa

Depozitimet e Kuaternarit

Depozitimet e Kuaternarit ne zonen e studjuar prej nesh ,ndeshen ne 2/3 e siperfaqes, duke zene pjesen qendrore dhe veriore. Ato perfaqesohen nga depozitime aluviale te Holocenit te Vonshem (rreth 3500 vjet).

Ne periudhen e Holocenit te Hershem, lumi i Semanitderdhej ne detin Adriatik, duke kaluar nga Fiershegani ne drejtim te Karavastase. Vete delta e Semanit ne afersi te ketij fshati ,ka qene nje nga skelat e hershme te ketij rajoni, e quajtur skela e Pirgut.Pas kesaj rreth 3500 vjet me pare, lumi i Semanit duhet te kete ndruar drejtim, duke kaluar nga gryka e Mbrostarit, duke mbushur fushen e Semanit. Ne pergjithesi depozitimet aluviale kane perberje te imet, te perfaqesuara nga rera te imta, alevrite dhe argjila, me trashesi qe nuk i kalon 100 m. Krahas depozitimeve aluviale jane ndeshur dhe depozitime proluviale, ne rreze te kodrave te zones se studjuar, ne menyre te vecante ne rreze te kodrave te Zharrezes.Trashesia e tyre arrin ne 30-40 m. dhe kane perhapje te kufizuar.

Klasifikimi i tokave

Sipas studimeve te kryera nga institute i tokave konkludohet qe Histosolet shtriheshin ne 3,978 ha ose 0.56 perqind te siperfaqes se pergjithshme te tokave bujqesore.
Siperfaqja aktuale e Histosoleve eshte ulur krahasuar me ate te me shume se 40 viteve me pare, meqenese shume prej tyre shfaqen si Molisole, Vertisole dhe/ose Histosole. Vertisolet ne Shqiperi zene nje siperfaqe prej 58,000 ha ose 2 perqind te siperfaqes se pergjithshme te vendit. Pjesa me e madhe e vertisoleve gjenden ne zonat fushore te ultesires bregdetare dhe demonstrojne cilesite e regjimit termik te zones ku takohen. Te gjitha tokat e pasura me magnezium jane formuar mbi shkembinj bazike ose ultrabazike ose derivate te tyre dhe klasifikohen si Vertisole, ne menyre me specifike si nenrendi Usterts dhe Aquerts.

Molisolet zene 7.25 perqind ose afersisht 208,000 ha te te gjithe siperfaqes se vendit. Ato gjenden si ne zona me klime te ngrohte (154,894 ha) ashtu ed he ne zona me regjim termik mesatar dhe te ulet (53,508 ha). Molisolet e formuara mbi aluvione te shkembinjve gelqerore, ranore dhe rreshpore, si ato te disa zonave bregdetare, jane shume pjellore.

Alfisolet mbulojne rreth 498,670 ha ose afersisht 17.3 perqind te siperfaqes se pergjithshme te vendit. Tipari kryesor pedologjik I ketyre tokave eshte ekzistenca e horizontit argjilor (Bt),i cili i klasifikon ato si Alfisole. Perafersisht 60 perqind e tyre, perfshire Ustalfs dhe Xeralfs,ndeshen ne zona me regjim termik te larte. Te tjera

Inceptisolet shtrihen ne pjesen me te madhe te vendit. Siperfaqja e pergjithshme e tyre eshte 1,015,951 ha ose 35.3 perqind e siperfaqes se Shqiperise dhe jane te shpemdara ne zona me regjim te ndryshem termike, te larte, mesatar dhe te ftohte. Nengrupet kryesore sipas Klasifikimi t te Tokave jane Aquepts, Ochrepts dhe Umbrepts. Entisolet perbejne 5.7 perqind te siperfaqes se pergjithshme te vendit. Ato jane te shperndara ne te gjithe Shqiperine, ne zonat me temperatura te larta. Nga nengrupet, jane ndeshur vetem Psamments, Fluvents dhe Orthents.Ne varesi te klasifikimit te tyre, Entisolet njohin perdorime te ndryshme ne Shqiperi.

Fluvents jane toka shume te mira me mundesi te medha per zhvillimin intensiv te fermave. Vendndodhja e tyre eshte e shkelqyer per kultivimin e pambukut, orizit, misrit dhe perimeve, por varet edhe nga kapaciteti vadites. Orthents jane me mundesi te kufizuara per perdorim bujqesor, por jane shume te pershtatshme per pyllezim dhe kullote, per sa kohe mund te kontrollohet erozioni.Tokat Midslope jane te ceketa, me kontakt litik dhe pergjithesisht jane te mbuluara nga sh kurre dhe pyje. Ne lartesi te medha paraqiten ne trajte shkembi te zhveshur ose si perzierje e shkembit me pak dhera te shkrifeta. Kjo kategori perfshihet ne grupimin e perzier te Tokave shkembore me Orthents, Toka shkembore me Ochrepts dhe Toka Shkembore. Ne dy grupet e para, raporti mes dherave te shkrifet dhe shkembit eshte 1:4, ndersa grupi i fundit eshte thjesht shkemb. Keta nengrupe gjenden ne te gjithe Shqiperine, kryesisht ne zona me klime mesatare dhe te ftohte. Te gjithe bashke ata zene rreth 32 perqind te territorit te vendit. Kjo eshte nje siperfaqe mjaft e madhe e cila mund te perdoret per qellime te ndryshme si miniera, pyllezim, kullote ose si zona natyrore te mbrojtura.

Perdorimi i tokes

Aktivitetet kryesore janë bujqesia blegtoria gje qe kushtezon edhe perdorimin e tokave per qellime blegtorale dhe bujqesore. Faktoret klimaterike, gjeologjike e morfologjike kane kushtezuar nje zone ku mbizoterojne tokat e hirta-kafe. Varferia ne humus e tokave ka kushtezuar perdorimin e tyre si kullota te varfera.
Zona i eshte nenshtruar ndikimit te veprimit njeriut. Veshja bimore e kodrave eshte djegur disa here me qellim hapjen e tokave te reja, te cilat jane mbjelle me dru frutore e kryesisht me ullinj.

Sizmiciteti

Te dhenat per sizmicitetin e Shqiperise mbulojne nje periudhe 2000 vjecare dhe jane paraqitur ne kataloget e ndryshem per termetet (Sulstarova & Kociaj, 1975; Muco 1998). Nje katalog i plote per terrenetet ne Shqiperi u perpilua ne vitin 1975 dhe eshte revizionuar gjate

periudhes 2000-2005 (Sulstarova etj, 2005). Ai permban rreth 680 termete me manjitude me te madhe ose te barabarte me 4.5. Katalogu mbulon nje periudhe kohore nga 58 BC derine 2005, dhe zonen midis 18.5-21.5° L dhe 39-43°Y. Intensiteti i termeteve eshte klasifikuar ne terma te manjitudes vale-siperfaqesore (M). Ne orogjenin Shqiptar janë prezentë tre zona te thyerjeve aktive gjatesore dhe dy te thyerjeve terthore, si me poshtë (Aliaj,2000;SulstarovaetaL,2001):

- Zona e thyerjeve mbulesore Ionian-Adriatik, me tendence VP deriafersisht VVP
- Zona e thyerjeve te Grabenit Shkoder-Mat-Librazhd,metendenceVP
- Zona e thyerjeve te Grabenit Peshkopi – Kore me tendence N-J
- Zona e thyerjeve normale Shkoder-Tropoje me tendenceVL
- Zona e thyerjeve normale Elbasan-Diber me tendence YL

Epiqendrat kryesore te termeteve jane te lidhura me thyerjet active ne Shqiperi.

Zona e thyerjeve normale Shkoder-Tropoje, me tendence VL, eshte me thyerje normale, kryesisht gjate kufirit YP te zones ofiolitike Mirdita. Zona e thyerjeve eshte pare si pjese zones sismogjenikeS hkoder-Peje, e cila nderpret te dyja territoret e brendshme dhe te jashtme te Shqiperise nga JJP drejt VVL. Ne territore te brendshme, ajo manifestohet ne grabenin Pliocen-KuaternarteTropojes (meterheqjeVVL) dhe gjithashtu me nje trend thyerje norrnale LVL pergjate kufirit verior te zones Mirdita. Ne territoret e jashtme, ka nje tendence L-P te thyerjes rreshqitje-kunder hedhje, qe zgjatet nga Lezha deri ne Gjirin e Drinit (Aliaj,2000; Sul starova e tal, 2001). Zgjidhja e mekanizmit fokal te termeteve qe gjenerojne nga zona sismogjenike Shkoder-Peje ne zonat e brendshme deshmon per nje regjim stresi tensional me tendence VPV. Vleresime te ndryshme per potenciale te pritshme sismike te kesaj zone jane dhene me pare. Sipas Aliaj (1982, 1998) dhe Sul starova etj.(1980),potenciali i pritshem sismik I kesaj zone sismogjene eshte Mmax =5.5 deri ne 5.9. Duke perpunuar burime te zonave sismike ne Shqiperi (Aiiajetj.2004), ata kane llogaritur nje burim te ri te zones Shkoder-Tropoje me manjitude me shume se Mmax=6.9. Ne total, me shume se17,000 mikro terrnete me manjitude lokale ML>1.0 jane shenuar nga Stacioni Sismologjiki Bajram Currit, me i afermi stacion ne kete zone. Koordinatat e hipoqendravete1,800 prej ketyre evenimenteve jane percaktuar. Rreth 300lekundje jane ndier dhe kane shkaktuar deme te vogla ne epiqendrat e tyre. Intensiteti kumulativ ka qene i shkalles VI-VII sipas shkallesMSK-64. Manjituda maksimale e termetit nga ky ndikim ka qene ML=4.6 dhe mikrotermetet kane qene te ceket, deri 10-15 km thellesi (Muco,199I).

Hidrografia e Rajonit

Kompleksi hidrogjeologjik i depozitimeve te Neogjenit perfshin tre horizonte kryesore ujembajtese:

a-Horizonti ujembajtes i formacionit"Rrogozhina" b-Horizonti ujembajtes i formacionit "Helmesi"

c-Horizonti ujembajtes i depozitimeve te Mesinianit a-Horizonti ujembajtes i formacionit "Rrogozhina"

Depozitimet e suites "Rrogozhina" zene pjesen kryesore te territorit te Fierit dhe dalin ne siperfaqe ne strukturat e Patos-Marinezes, Krapsit, Bregasit, Frakulles dhe Ardenices. Depozitimet e kesaj serie jane takuar ne thellesi, poshte depozitimeve kuaternare ne zonat e uleta fushore nga mjaft puse nafte dhe hidrogjeologike.

Depozitimet e kesaj serie karakterizohen nga nga ndryshime te medha facialo- litologjike gjate shtrirjes dhe renies se tyre. Si rrjedhim, prerja litologjike per zona te ndryshme paraqitet jo e njejte.

Keshtu ne zonen e Patosit mbizoterojne pakot konglomeratike dhe ranore, ne strukturen e Ardenices pako ranore, ne strukturen e Krapsit pako ranore dhe argjilore. Trashesia e ketyre shtresave leviz nga 80-120 m ne strukturen e Patosit, 260-280 m ne strukturen e Zharrezes, 200-250 m ne strukturen e Bregasit si dhe ne zonen e Roskovecit-Strumit. 300-350 m ne zonen e Frakulles, 240-270 ne strukturen e Krapsit dhe 200-250 ne strukturen e Ardenices.

Nga pikpamja hodrogjeologjike me teper interes paraqesin pakot konglomeratike ranore dhe ranore-argjilore. Ne pakot konglomeratike te zones se Zharrezes dhe ato konglomeratiko-ranore te zones se Vanajt (struktura e Ardenices) puset hodrogjeologjike kane dhene uje me vetrrjedhje nga 8-22 l/sek.

Depozitimet e formacionit "Rrogozhina" shtrihen pergjate kodrave te fshatrave Roskovec, Strum e Kuman me drejtim P-L dhe me zhytje ne drejtim te veriut pikerisht poshte fushes se Marinzes. Ato jane pershkruar me hollesi ne paragrafin e te dhenave gjeologjike.

Keto depozitime perfaqsohen nga: argjila. Alevrolite ranore dhe aty ketu me konglomerate kompakte si dhe alternime te tyre ne formen e ndershtresave.

Ranoret jane ngjyre gri ne te verdhe deri ne te gjelber, jane kokerr ndryshem te cimentuar ne shkalle te ndryshme me cimento karbonatike. Shpesh takohen nga te shkrifeta deri ne te forta.

Konglomeratet nga pikepamja hidrogjeologjike paraqesin interes per ujembajtjen e tyre dhe cilesine. Ato jane kokerr mesem e kokerr medhenj te cimentuar me cimento karbonatiko-ranore. Jane mesatarisht te forte. Keto konglomerate ndodhen ne thellesine nga 140 m deri 280-350 m.

Klima

Klima e Shqipërisë është e larmishme si rezultat ipozicionit të saj gjeografik, lartësisë gjeografike dhe vecanërisht relievit të saj kodrinore malor që karakterizohet nga lugina egrykamali të theksuara. Dallimi i katër zonave dhe trembëdhjetë nën- zonave klimatike përcaktojnë tipe tkryesore të bimësisë në vend.

Republika e Shqipërisë shtrihet në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në bregdetin Adriatik dhe Jon. Ajo shtrihet në koordinatat midis 39°38-42°39V d h e 19°16-

21°04L14. Vendi zë një sipërfaqe prej 28,748 km2melartësi të ulëta te rivierës bregdetare në perëndim që lartësohen në malësitë e pjesëve veriore, qendrore dhe jugore.

Vendi karakterizohet nga një klimë tipike mesdhetare, dmth verë e nxehtë dhe e thatë me ditë të gjata dhe dimër I butë me reshje të shumta shiu. Reshjet në Shqipëri shoqërohen zakonisht me erë që fryn nga jugperëndimi dhe ndikohet nga relieve duke krijiuar në këtë mënyrë një model të larmishëm klimatik e reshjesh në rajone të ndryshme te vendit.

Në pjesën veriore të Shqipërisë (Alpet), sasia mesatare e reshjeve është mbi 2,500mm, ndërsa në luginat në brendësi të vendit sasia e reshjeve është 650-700 mm. Shpërndarja vjetore maksimale e reshjeve arrin në rreth 40% e haset zakonisht në dimër dhe ajo minimale prej 10% haset në verë. Maksimume të tjera dytësore hasen në brendësi të vendit. Numri I ditëve me shi (>1.0mm) ndryshon nga100-130 ditë në vit, kryesisht,gjatë muajve të dimrit. Thatësira te verës spikasin më tepër në pjesën jugperëndimor.

Ajri

Ne qarkun e Fierit, temperaturat mesatare mujore levizin midis 7.2 0C ne Janar dhe 24.8 0C ne Gusht. Temperatura mesatare vjetore (si rezultat i matjeve afat gjata) ne rrethin e Fierit eshte 15.9 0C si ne tabelen me poshte. Temperatura me e larte e matur eshte ne gusht te 1957 afersisht 45 0C dhe me e uleta poshte - 4.5 0C; eshte matur ne Janar 1968.

Gjendja social ekonomike e rajonit

Komuna Zharrëz është pjesë e qarkut të Fierit dhe ndodhet në Lindje të këtij qyteti i cili kufiozohet nga komunat Mbrostar, Kuman, Portez dhe Qendër, bashkitë e Roskovecit dhe të Patosit. Sipërfaqa e komunës 2457.9 hektarë, ndarë në 6 fshatra. Të gjithë fshatrat e komunës kanë lidhje me rrugën kombëtare Fier-Berat.

Komuna Zharrëz

Komuna Zharrëz ka 6 fshatra: Sheqishta, Belina, Zharrës, Fshat I Ri, Frashër, Verbas. Popullsia totale e komunës është 8026 banore dhe 1927 familje. Popullsia e gjithë zonës së studimit është 186,266 banorë, 43,734 familje dhe 19,728 shtëpi, sic paraqitet dhe në tabelën më poshtë. Bashkia Ballsh ka numrin më te madh të popullsisë dhe familjeve në këte zone. Të gjithë fshatrat e komunës Zharrëz janë përfshirë në projektin PIS.

Infrastruktura

Në vitin 2003, Fieri kishte 585.6 km që përfaqëson 19.2 për qind të rrjetit rrugor të vendit,

me 60 për qind të rrjetit të përgjithshëm të shtruar. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ka qenë një nga prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të Fierit, veçanërisht të rrjetit rrugor komunal i cili ishte i varfër dhe pengonte rritjen ekonomike.

Që nga viti 2004 është rritur nvestimin kombëtar në infrastrukturën rrugore dhe ka qenë një përmirësim i dukshëm në rrjetin rrugor kombëtar dhe komunat përreth. Rrjeti i përgjithshëm rrugor në vitin 2008 në rrethin e Fierit ishte 860km. Bankers ka mbështetur në përmirësimin e rrjetit rrugor dhe komunat përreth që nga viti 2004 për të përmirësuar rrugët dytësore dhe lokale për qasje në fusha. Fshatrat e komunës Kuman kanë një qasje të mirë komunikimi me qytetet më të afërt si Roskovec, Patos dhe Fier dhe komunën Qendër. Gjatë viteve të fundit disa rrugë të reja janë ndërtuar dhe kanë zvogëluar distancën e fshatrave me qytetin e Fierit dhe në të njëjtën kohë autostrada Fier-Lushnje, nëpërmjet urës së Kallm. Rrugët e brendshme të fshatrave janë përmirësuar në vitet e fundit. Në komunën Mbrostar autostrada që kalon nëpër komunë krijon mundësi të shkëlqyera lidhje me fshatrat mes tregut të Lushnjës dhe Tiranës. Në komunën Portëz sistemi i ri i rrugëve ka vendosur komunikim të mire me qytete e Fierit, Patosit dhe qendren e komunës. Problemi është rruga që lidh qendrën e komunës dhe qytetin e Fierit me fshatrat Kraps dhe Plyk. Rrugët e brendshme të fshatrave janë përmirësuar në vitet e fundit. Nevojë në këtë komunë është që të ndërtohen rrugë të reja për plantacionet e mbjella me ullinj.

Zonat e mbrojtura

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokësdhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin ebiodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë tëmenaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti izonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Tëgjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtur ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante.



VLERESIM I NDIKIMIT DHE MASA LEHTESUESE TE PROJEKT ZHVILLIMIT

Ne seksionin e vleresimit te ndikimi ne mjedis, ku theksi kryesor ne kete proces do te jete per vleresimin e faktoreve kryesor gjate fazes se operimit. Ne seksionin e meposhtem do te vleresohen si ndikimi gjate fazes se operimit ku per kete faze do te jete perqendrimi kryesor. Ndikimi ne mjedis dhe masat parandaluese do te pershkruhen per secilin tregues mjedisor, do te paraqiten dhe identifikimi i kriteries, magnituda e ndikimit dhe vleresimi me sinjifikativ.

Identifikimi i faktoreve mjedisor.

Duke u mbeshtetur ne legjislacinin ne fuqi mjedisore faktoret kryesor do te vleresohen ne menyre me te detajuar ku do te percaktohen qarte kriteret e percaktuar me siper, ku disa prej tyre jane ujerat nentokesor, vendndodhja dhe perdorimi i tokes, impakti social-ekonomik, ajeri, flora fauna, zhurmat, impakti viziv, etj.

Vleresim i ndikimin ne mjedis gjate fazes se ndertimit.

Komponentet e mjedisit te cilat mund te ndikojne ne mjedis gjate fazes se ndertimit jane ne pergjithesi nga ndertimi i struktures, levizja e mjeteve te tonazhit te rende, dhe trafikut. Ky ndikim vleresohet i njejte me cdo impakt qe shkaktohet nga ndertimi i strukturave civile, ky impakt eshte minimal pasi nuk ndodhet ne zone te banuar, ndodhet larg zonave me status te vecante si monumente natyrore apo zona te mbrojtura. Ne menyre te permbledhur do te paraqiten ne tabelen permbledhese (Vleresimi i ndikimit dhe masat lehtesuese gjate fazes se operimit)

Vleresim i ndikimit ne mjedis gjate fazes se operimit.

Ne tabelen e meposhtme do te paraqiten shkaqet kryesore qe ndikojne ne mjedis gjate fazes se operimit, dhe faktoret korespondues te impaktit :

Komponentet e projektit	**Faktoret mjedisor**
Shkarkimet ne ajer	Ajri
	Uji Flora
	Fauna
	Perdorimi i tokes
Shkarkimet e lengeta	Toke
Operim ne objekt	Zhurma
	Social
Struktura dhe peisazhi	Vizual
	Flora fauna

Ne kete seksion do te paraqitet ne impaktin dhe masat parandaluese per cdo faktor qe do te

ndikoj ne mjedis dhe ne menyre te detajuar do te paraqiten te dhena specifike ne lidhje me impaktin e kesaj veprimtarie ne cilesine e ajerit dhe te ujit,ne te cilen ky aktivitet ndikon pasi ne faktoret e tjere ndikimi eshte minimal dhe i lokalizuar. Do te percaktohen ne menyre te detajuar normat e shkarkimit ne ajer te impantit dhe krahasuar me vlerat kritike. Ne menyre te permbledhur do te paraqiten ne tabelen permbledhese(Vleresimi i ndikimit dhe masat lehtesuese gjate fazes se operimit)

Vleresimi i ndikimit dhe masat lehtesuese gjate fazes se operimit

Ajri			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Cilesia e ajerit: perhapja e pluhurit gjate fazes se ndertimit dhe puneve ne toke(psh germim te sheshit per rehabilitim te pusit dhe zones perreth)	Zhvillimi i procedurave per: - sperkatja me uje e rrugeve ne shesh dhe pirgjeve te materialeve inertesh - mbulimi i automjeteve qe transportojne ngarkesa materialesh per te parandaluar perhapjen e pluhurave nga automjetet - kufizimet e shpejtesise ne siperfaqet e pashtruara ne zone per te kufizuar ngritjen e pluhurit	Perhapja e pluhurit do te jete e perqendruar ne zonen e ndertimit dhe nuk do te ndikoje komunitetin vendor pasi ndodhet larg zones ne vleresim . Sidoqofte, punetoret duhet te pajisen me maska kunder pluhurit, vecanerisht ne stine/ dite te thata .	Ndikim negativ i vogël

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Importimi i ndotesve si pjese e lendeve qe do te perdoren gjate procesit te ndushjes dhe nivelimin te tokes	Sigurimi se ndotesit nuk jane te pranishem ne materialet e importuara ne zone duke zgjedhur burimin e duhur te materialeve dhe duke bere analizat kimike. ne se do te jete e nevojshme	Potenciali per importin e ndotesve ne material do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Shkarkimi/clirimi aksidental gjate transportit i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e rehabilitimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit te materialeve	Potenciali per shkarkimet/ clirimet aksidentale gjate transportit te materialeve ne zone do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e kantierit, gjate grumbullimit dhe largimit te mbetjeve me hidrokarbure	Te gjitha zonat e magazinimit do te kene masat e duhura te sigurise mjedisore per te parandaluar shkarkime aksidentale ne toke.	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate fazes se magazinimit ne zone do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e punes, gjate transportit per ne vendin e perdorimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit te materialeve per sa kohe jane ne zonen e zhvillimit	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate transportit dhe trajtimit te lendeve brenda zones se zhvillimit do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, gjate perdorimit psh rimbushja me lende djegese, mirembajtja, etj.	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura si dhe monitorimi i trajtimit e perdorimit te materialeve. Aty ku eshte e mundur, zonat ku behet rimbushja me	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate perdorimit do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
	lende djegese dhe zonat e mirembajtjes do t'i nenshtrohen nje kontrolli te posacem		
Derdhjet aksidentale te mbetjeve te lengshme gjate largimit nga zona	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura dhe monitorimi i largimit te mbetjeve nga zona	Potenciali per shkarkimet aksidentale te mbetjeve gjate largimit nga zona do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkim aksidental i ujrave te zeza ne toke dhe rezervat ujore tokesore nga punetoret	Ujrat e zeza nuk do te shkarkohen ne toke, por do te shkarkohen ne piken e ujerave te zeza qe do te aprovohet nga autoriteti vendor.	Asnje	Ndikim i paperfillshem / Zero
Ndotja e ujerave nentokesor dhe siperfaqesor nga ujerat e zeza te ketij projekt zhvillimi	Sigurimi se punimet ndertimore ndjek standardet dhe udhezimet vendore dhe nderkombetare. Mbetja e fazes perfundimtare nuk do te kete ndikim te theile negativ ne rezervat ujore. Punimet do te jene te programuara ne menyre te tille qe te perballoje kapacitetin e te gjithe proceseve te rendesishme dhe ndikuese te ndertimit.	Potenciali per shkarkimin e demshem te mbetjeve te lengshme nuk parashikon hollesira apo nuk eshte menaxhuar mire.	Ndikim negativ i vogël

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Shkarkimi i ndotesve ne toke nepermjet ujit, pajisjeve dhe larjes se makinave gjate kesaj faze	Aktivitetet larese do te zhvillohen ne nenzona me kontrolle e procedura te pershtatshme dhe do te monitorohen per te siguruar se masat parandaluese jane eficente.	Potenciali per shkarkimin aksidental te ndotesve ne toke gjate aktiviteteve laresetpsh te mjeteve te tonazhit te rende ndertimore, etj) do te minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Rritja e permbajtjes sedimentare te ujit ne receptoret ujore natyrore si rezultat i derdhjes se drejtperdrejte te lendeve	Minimizimi i germimeve gjate fazes Ndertimore ne periudha me reshje te dendura Kanalet e perkoheshme te sistemit te kullimit dhe pellgjet e sedimentimit per mbledhjen e rrjedhjeve siperfaqesore dhe derdhjen e tyre ne perrenjte qe kalon prane zones	Asnje pasi shkarkimet do te jene ujera te pa ndotur me substanca te demshme apo ne sasi te larte qe mund te behen shkak i permbytjeve/rritje te nivelit te ujit ne permasa te ndjeshme	Ndikim i paperfillshem
Ndotja e receptore ujore natyrore si rezultat i derdhjes se ujrave te zeza te papermuara	Ndertimi i nje sistemi te kanalizimeve eshte i nevojshem ne zonen ekzistuese pasi nuk ekziston ne zone rrjeti i kanalizimeve ku do te shkarkohen ujerat e ndotura qe do te prodhohen nga punonjesit ne terren. por kjo eshte detyre e pushtetit lokal. perkohesisht do te montohet nje rezervuar i perkohshem ku do te grumbullohen keto	Asnje	Ndikim i paperfillshem

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
	ujra te cilet do te derdhen ne kolektoret perkates, te percaktuar nga autoritetet perkatese		
Ndotja e ujrave siperfaqesor si pasoje e rjedhjes se substancave ndotese	Perdorimi i materialeve ndertimore qe nuk perbejne rrezik per shendetin e njeriut dhe mjedisin Magazinimi i materialeve te mundshme ndotese ne zonat te pershtatshme e mbajtja e tyre nen kontroll. Cdo pjese toke e ndotur gjate fazes ndertimore do te hiqet e do te depozitohet ne zonat e depozitimit te mbetjeve te rrezikshme nese konstatohen substanca te tilla gjate fazes se ndertimit	Asnje	Ndikim i paperfillshem

Përdorimi i materialeve dhe menaxhimi i mbetjeve			
Ndikimi mjedisor	Masat zbutëse të propozuara	Efekti i mbetur	Shkalla e vlerësimit të efektit të mbetur
Prodhimi i mbetjeve	Ripërdorimi i dheut. Ruajtja e mbetjeve dhe proçedurat e kontrollit. Seksioni i mbetjeve të ngurta urbane	Largimi i mbetjeve nga zona do të kryhet nëpërmjet institucioneve përgjegjëse / Rrethi Fier	Ndikim negativ i vogël.

Ekologjia **(Terreni: zona e implementit te projektit pa u cenuar hapesirat perreth)**			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese te propozuara**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Humbja e bimesise gjate pastrimit te terrenit	Zhvendosja e dheut dhe disa specieve bimore per te ndihmuar rehabilitimin e zonave te zhveshura perreth. Programi i Rehabilitimit te Habitateve qe perfshin "Vrojtimin e Habitateve dhe Studimin e Manaxhimit" vecanerisht ne zonat fqinje nese konstatohen raste te tille, per t'u percaktuar, dhe ne bashkepunim te ngushte me ekologet dhe komunitetet vendore); mbledhja e bimeve; dhe krijimi i nje fidanishteje nese konstatohem se duhet te nderhyhet ne ndonje zone te veshur edhe pse ne kete faze te vleresimit nuk konstatohen bimesi te larta te rendesishme ne zonen ku do te ndikohet	Humbja e bimesise sado i vogel qofte ndikimi nuk mund te shmanget por mund te kompensohet nga rehabilitimi me sukses, permiresimi dhe manaxhimi afatgjate i zonave perreth per konservim dhe perdorim produktiv te ujerave nentokesor gjate fazes se ndertimit	– Ndikim negativ minimal dhe Ndikim i pa perfillshem (zona fushore pa bimesi)

	Perfshirja e shuminit te bimeve te rrezikuara (Lista e Kuqe Shqiptare) nese do te jete e kerkuar nga specialistet		
Shfrytezim i metejshem i tokes (humbja e habitateve) per kampin e perkohshem te ndertimit	Ndertimi i kampit te perkohshem ne truallin qe me kalimin e kohes do te shfrytezohet si rruge apo sheshe per parkim te mjeteve.	Asnje ndikim shtese pasi perdorimi i tokes do te ndodhe gjithesesi ne terrenin e zones	Ndikim i paperfillshem / Zero
Shkaterrimi i faunes dhe habitateve te tyre (gjitaret, shpendet, zvarraniket, amfibet, vertebroret)	Vrojtim i metejshem i ekologjise / faunes ne stinet e duhura dhe monitorimi i vazhdueshem nga nje specialist i shoqerise	Nuk do te jete e nevojshem zhvendosje te tyre pasi keto hapesira jane te pershtatshme per jeten e faunes ne keto terrene,ku prania e punonjesve eshte e paket dhe nuk do te ndikohet nga punimet ne terren	Ndikim negativ i paperfillshem
Ndikim ne perberjen ekologjike te zones perreth nga fiqia punetore e te ndertimit te perkoheshme si rezultat i pastrimit te terrenit nga bimesia	Program edukimi, monitorimi dhe zbatimi. Mbajtja e mbetjeve dhe shmangia e keq perdorimit nga punonjesit apo depozitimi i tyre ne terren	Zbatimi mund te mos jete i lehte dhe parashikohet ndonje ndikim minimal.	Ndikim i vogel negativ – ndikim i moderuar (ne varesi te zbatimit dhe aftesise se kontrollimit dhe ndergjegjesimit)

Ndikimi peizazhor dhe vizual			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Demtim i karakterit peizazhor dhe bukurise pamore per shkak te prezantimit te tipareve dhe veprimtarive qe nuk jane ne harmoni me peizazhin	Planifikim sensitiv i terrenit te punes dhe tere kompleksit te punimeve qe do te verehen gjate kesaj faze Mbjelle sipas strukturave te avancuara. Minimizimi i ndricimit dhe punimeve gjate nates.	Nuk do te kete ndryshim te karakterit rural te peizazhit dhe humbjes se bukurise pamore kryesisht per shkak te aktiviteteve qe tashme jane ekzituese. Ndikim do te kete vetem nga prania e mjeteve te ndertimit qe do te veprojne ne kete faze.	Ndikim i paperfillshem Ndikim i vogel negativ

Zhurma dhe vibrimin(perfshire dhe transportin)			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Zhurme nga ndertimi i objekteve: Ndertimi i rrugeve /rrugicave dhe gropes septike dhe pus shpimit /depo uji per furnizimin me uje	Manaxhimi i mire i zones: Zgjedhja e duhur e makinerive: Metodat e punes: Oret e punes: Trajtimi me eficence i materialeve.	Pa njohur detajet eshte e pamundur te parashikohet nese do te kete nrtje te zhurmave ne qendrat e banuara ne kete faze te vleresimit edhe pse ato ndodhen larg zones se banimit. Zonat e banimit ndodhen larg ketij aktiviteti pasi eshte e vleresuar si zone e pa shfrytezuar si zone rezidenciale por vleresohet si zone komerciale dhe industriale.	N/A (e pazbatueshme)

Ndikimi peizazhor dhe vizual			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Zhurme nga trafiku ne fazen ndertimore qe vjen nga perdorimi i rrugeve ekzistuese qe kalojne nepermjet qendrave te banuara.	Percaktimi i itinerarit te rrugeve te reja me numrin me te vogel te pronave ne afersi te tyre. Mbajtja ne minimum e qarkullimit te makinave. Pas ndertimit, i gjithe fluksi i trafikut qe lidhet me ndertimin e zhvillimit do te pershkoje vetem rruget qe do te vleresohen si te pa demshme per mjedisin publik.	Mund te kete rritje te zhurmave ne vendbanimet ne afersi te itinerarit te zgjedhur si segmenteve rrugore per transportin e materialeve.	Ndikim i vogel negative

Ndikime sociale			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Problemet shendetesore te punetoreve te ndertimit mund te ndikojne ne pune dhe pagesen e tyre	Specifikim i perfitimeve te arsyeshme lidhur me semundjet dhe raportin e paguar	Semundja per nje periudhe te caktuar do te ndikoje tek fitimet. Kthimi i shpejte ne pune mund te demtoje shendetin.	Ndikim negativ i vogël
Punetoret – raste emergjente ndertimore	Per te gjitha rastet emergjente, do te vendosen marredhenie kontraktuale me Fier per sherbime dhe trajtimeve cilesore te rasteve.	Ne varesi te rastit.	Ndikim negativ i vogël

Ndikime sociale			
Ndikimi mjedisor	**Masat zbutese e propozuar**	**Efekti i mbetur**	**Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur**
Kushtet e jeteses dhe cilesia e jetes se punetoreve. Ndikimet e sherbimeve publike dhe komunale ne fshatrat perreth.	Shoqeria ndermese do ti jap specifikat e detajuara te skices se vendosjes se vendqendrimit te punonjeve qe do te ngrihen ne te dhe ofrimin e sherbimeve (bashke me largimin e mbeturinave) ne perputhje me standardet e percaktuara nderkombetare. Investitori do te monitoroje kushtet e punes si dhe sigurine e shendetin.	Ne varesi te ndjeshmerise se individit. Ne se kushtet nuk jane te mira, nje sere ceshtjesh mund te ngrihen ne vendqendrim e me pas do te perhapen ne komunitetin vendor.	Ndikim negativ i vogël
Shqetesimet dhe konfliktet ne kamp	Kodet e sjelljes ne kamp dhe zbatimi me detyrim i disa ceshtjeve kyce te sjelljes	Nuk eshte identifikuar asnje	Ndikim negativ i vogël

Ndikimi social (pozitiv)	Masa zbutëse të propozuara	Efekti i mbetur	Shkalla e vlerësimit të efektit të mbetur
Rritja e punësimit (Ndryshim poitiv)	Rekomandim i masave për shtimin e punësimit dhe përmirësimin e kapaciteteve të komunitetit lokal	Kjo është në aftësi të aftësive të të rinjve dhe interesimit të tyre, në mundësitë që ofron investitori dhe kategorive të përcaktuara në punësim.	Ndikim pozitiv i vogël
	Reduktimi i të rinjve aktualisht t ë trajnuar jashtë qytezës së lindjes		
	Ofrimi i praktikës/ trajnimeve për personat që kanë nevojë për ngritje kapacitetesh në punë		
	Identifikimi i kategorive të të rinjve që do të punësohen në bazë të aftësive.		
	Publikimi i kategorive të punësimit në buletinin		

	informativ lokal. Në të ardhmen politika e rekrutimit do të përfshijë sponsorizim të pjësshëm të arsimit të lartë (diplome në shkencat ekzakte apo të tjera të ekuivalente) për ounonjsit/ të rinjtë.		
Rritja e taksës së biznesit dhe të ardhurave të bashkisë (Ndryshim pozitiv)	Ofrimi i asistencës për formulimin e projekteve dhe forcimin e aftësive të mbrojtjes së tyre, në se kërkohet nga komiteti koordinues. Fitimet nga rritja e të ardhurave ne buxhet mund të përdoren për të përmbushur këto objektiva. Subjekti do të ofrojë trajnim për përmmirësimin e kapaciteteve mbi planifikimin dhe formulimin e projekteve.	Rritja e të ardhurave bashkiake për rajonin naftëmbajtës Qarku Fier	Ndikim pozitiv i vogël
Përmirësime në fushën elektrike dhe përmirësime të tjera infrastrukturore (nëse realizohen, përmirësimmi do të ketë ndikim neutral ose pozitiv)	Asnjë identifikim: por nëse do të ketë përfitime ai do të jetë rastësor ose një përfitim i jashtëm	Zero	Ndikim neutral ose pozitiv i ogël nëse do të konstatohet)
Shëndeti dhe cilësia e jetesës së banorëve	Kryerja e një vlerësimi të rreikut që mbulon këto aspekte dhe identifikon masat zbutëse Regjistrimi i sëmundjeve-shkaktuar nga pluhurat-nga punonjsit e qëndravelokale e shëndetësore. Pyetësor mbi cilësinë e jetës për të monitoruar hurmën dhe shqetësimin	Në varësi të të dy rasteve a) Efikasiteti i proçesit të monitorimit b) Ndërmarrja e masave korrigjuese- në varësi të rastit, psh.. trajtimi mund të mos e zgjidhi problemin Rastet më problematike shëndetësore mund të kërkojnë ristrehim. Sidoqoftë numri i familjeve që ka të ngjarë të preken nuk parashikohet të jëtë i lartë, ndonëse pasojat për individë mund të jetë të pakta dhe minimale.	Ndikim i vogël negativ\mesatar
	Përcaktimi i masave të tjera zbutëse mbi bazën e ndikimeve të regjistruara si pasojë e proçesit të monitorimit		
Zona e trashëgimisë dhe e kulturës	Ky projekt nuk ndikon në zona të trashëgimisë kulturore apo historike pasi janë objekte funksionalë	Zero	N\A

PLANI I REHABILITIMIT DHE MENAXHIMIT MJEDISOR

Kompania "ALBETROL " SH.A çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet. Ky plan përfshin:

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme

Është një nga planet më me rëndësi të Planit të Menaxhimit të Mjedisit, ndonëse lidhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë me mjedisin apo ndikimin në të. Në bashkërendim të plotë me Kontraktorin e ndërtimit, i cili ende nuk është përcaktuar, do të hartohet një plan i kualifikimit të gjithë personelit që do të impenjohet në sheshin e projektit gjatë kohës së rehabilitmit . Trajnimi do të mbulojë kushtet ekzistuese të mjedisit, ndikimet potenciale në mjedis nga projekti i ndërtimit, implementimin e masave lehtësuese specifike ne minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative, dhe masat e përgjithshme mbrojtëse për mjedisin. Ky plan parashikon masat e përgjithshme mbrojtëse për mjedisin, pra për gjithçka që mund të ndodhë rastësisht apo qëllimisht brenda sheshit të ndërtimit qoftë të veprave tokësore siç është sheshi i shërbimeve, i ndërtesës se administratës, vete grupit të grumbullimit të naftës, pusit, dhe rrugës.

Ripërtëritja e mjedisit

Ndërtimi i sheshit të shërbimit që do të transformojë fushën ekzistuese në kantier, do të kërkojë dëmtimin e bimësisë së egër që rritet aty pari. Për fat të mirë kulturat bujqësore të mbjella mungojnë tërësisht. Në marrëveshje të plotë me pronarët përkatës, sipas një plani që do të përmendet paksa më poshtë, sipërfaqe përqark sheshit të shërbimit do të sistemohet duke marrë masa për ta ruajtur dhe mbrojtur nga erozioni. Ky plan përfshin minimizimin e lëvizjes së dheut, mbjelljen e barit në zonat ku parashikohet erozion si dhe ndalimin e dëmtimit të shkurreve aty pranë sheshit. Restaurimi dhe rehabilitimi i ndikimeve ndaj mjedisit do të kryhet si një domosdoshmëri në kthimin e pasurive të vlerësuara në kushtet e mëparshme, sa më mirë që të jetë e mundur Kjo do të jetë e mundur sepse vetë ai, Operatori BPA si dhe studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, që po paraqitet, kanë identifikuar ndikimet potenciale dhe masat që duhen marrë për parandalimin, minimizimin dhe mënjanimin e ndikimit të tyre.

Plani i menaxhimit të mbeturinave të prodhuara gjatë zbatimit të projektit

Në brendësi të këtij Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis, janë sqaruar të gjitha llojet e mbeturinave që do të gjenerohen si gjatë përmirësimit të infrastrukturës, gjatë gërmimit të themeleve apo bazamenteve të ndryshëm si dhe ndërtimeve që do të kryhen në këtë shesh.

Masat social-ekonomike

Zvogëlimi i ndikimeve social ekonomike nga faza e implementimit te studimit përfshin përpjekjet për shmangien e keqkuptimeve për punësim afatgjatë të punëtorëve lokalë, edukimin e popullatës mbi natyrën jo spekulative të ndërtimit të projektit në fjalë, shmangien e konflikteve me pronarët e tokës, duke pasur parasysh kompensimin si dhe trajtimin me respekt të banorëve të zonës. Operatori BPE ka bërë dhe po vazhdon të bëjë një punë të planifikuar dhe të kujdesshme, duke identifikuar pronarët e sipërfaqeve ku do të shtrihet sheshi i veprimtarisë së projektit si dhe vlerat reale të tyre nga regjistri kadastral i zonës. Për çdo të papritur që mund të ndodhë gjatë zbatimit të projektit, operatori ka marrë masa të lajmërojë autoritetet e pushtetit vendor dhe të veprojë në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi. Prania prej disa vjetësh e aksionarëve të operatorit në këtë zonë, nëpërmjet veprave konkrete, bën që çështja e masave social-ekonomike të rezultojë disi e thjeshtë për tu hartuar dhe njëkohësisht, po e tillë për tu zbatuar.

Planet e monitorimit

Gjatë zbatimit të punimeve për realizimin me sukses të plotë të projektit të ndërtimit të grupit të grumbullimit të naftës, puseve dhe infraastruktures do të përmbushë një plan monitorues mjedisor. Plani monitorues është krijuar për të monitoruar konturet e masave lehtësuese në planin menaxhues monitorues dhe ndikimeve që lidhen me zbatimin e projektit të propozuar. Ky plan monitorimi do të përfshijë aspektet e mëposhtme si monitorimi i ndotjes së terrenit në sipërfaqen ndarëse të veprimtarisë së Operatorit BPA dhe me subjektet e tjera privatë, monitorimi i ujërave që do të rrjedhin në afërsi të shesheve të projektit. Një plan të caktuar monitorimi, rekomandojmë që Operatori BPA të hartojë për ecurinë e depozitimeve të përkohshme të mbeturinave në gropat brenda sheshit të shërbimit dhe më pas depozitimin e tyre në gropat ekologjike të Zharrez dhe Portez.

Përmbledhje e masave zbutëse gjatë periudhës së ndërtimit

Ne identifikimin e masave zbutëse, theksi është vene ne teknikat e parandalimit te ndotjes te cilat përfshijnë teknologji me te pastra dhe minimizim te mbeturinave. Teknologjitë e identifikuara janë pjese e një game te gjere teknologjish te përdorura qe konsiderohen te jene praktikat me te mira aktuale për qëllimet e vendosjes te vlerës kufi te çlirimeve të gazeve apo pluhurave ndotës. Gjithashtu do te ndërmerren masa te tilla si ndryshime te brendshme ne impiant, zëvendësime te lendeve te para, rimodernizim te proceseve dhe praktika te përmirësuara te përpunimit dhe depozitimit te materialeve ne mënyrë qe te reduktohen çlirimet. Por, përveç instalimit te pajisjeve dhe operimit te procedurave për reduktimin e çlirimeve te mundshme, për te minimizuar ndikimet potenciale, është e këshillueshme te adoptohet një program i vazhdueshëm për menaxhimin dhe kontrollin e mjedisit, i cili do te fokusohet ne përmirësime te vazhdueshme me qellim parandalimin,eliminimin dhe/ose reduktimin progresiv te çlirimeve të gazrave. Për të arritur një gjë të tillë nga ana e Operatorit ALBPETROL duhen të kihen parasysh sa më poshtë: Ndërtimi i grupit të grumbullimit të naftës, puseve dhe infrastruktures duhet te kontraktohet sipas parimit EPC (Inxhinieri- Prokurim-Ndërtim) me një ose me shume kontraktues, te bazuar ne një procedure ndërkombëtare kualifikimi dhe

tenderimi. Zbatimi praktik i masave zbutëse i përmbledhur ne tabelën kërkon veprimet e mëposhtme:

Ceshtjet e mjedisit formojnë subjektin e një seksioni me karakter Zbatimi;

Specifikimet Teknike te Zbatimit përfshijnë te gjitha referencat e nevojshme për Praktikat me te Mira te Menaxhimit te Zonës se Ndërtimit te përmendura ne tabelën 2. Specifikimet do te mbulojnë parametrat respektive nga këndvështrimi ambiental si p.sh. kufiri i derdhjes për punimet e gërmimit, karakteristikat e materialit çakëll, metodat e ndërtimit, kërkesat për pajisje (përgjegjësi e ALBPETROL)

Pjesëmarrësve ne tenderë do t'ju kërkohet te përfshijnë ne ofertën e tyre një propozim për Planin e Ekzekutimit. Ky do te përfshijë një përshkrim te metodave te propozuara te ndërtimit, hollësi mbi pajisjet dhe një dokument specifik qe trajton te gjitha aspektet e menaxhimit te mjedisit (përgjegjësi e ALBPETROL);

Mbikëqyrja e punimeve do te kryhet nga një personel me eksperience ne mënyrë qe te monitorohet përputhja me specifikimet e kërkuara (përgjegjësi e ALBPETROL);
Masat zbutëse gjatë periudhës së implementimit

Veprimtaria	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse
Punime ne toke. Hedhja e mbeturinave te lëngshme	Ndotja e mundshme e ujit	Trajtimi i mbeturinave të lëngshme në vend. Nuk do te lejohet derdhja e këtyre mbeturinave

Punime të ndryshme ndërtimore në tokë. Kullim uji.	Depërtim i sedimenteve,vajit dhe grasos ne mjedhjet ujore te afërta.	Uji që mund te ndotet me vaj do te dërgohet te një ujë-ndarës (OES) brenda impiantit. Veçimi i të gjithë mbeturinave vajore dhe i lubrifikanteve që dalin nga mirëmbajtja e pajisjeve te ndërtimit dhe largimi i këtyre mbeturinave ne mënyrën e duhur. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për te larguar ujin e shiut nga struktura: mbajtëse dyrësore dhe largimin e naftës nga sipërfaqja e materialit te akumuluar.
	Çlirime të pluhurave nga pajisjet e ndërtimit	Asfaltimi sa më i shpejtë i rrugëve të sheshit të shërbimit. Lagja apo ujitja gjatë ndërtimit e sheshit të shërbimit
Përgatitja e sheshit dhe strukturave të tij	Çlirimi i tymrave te djegies nga pajisjet.	Mirëmbajtje e rregullt e mjeteve të ndërtimit. Zvogëlimi ne minimum i numrit të mjeteve
Punime në tokë. Shpërndarja e pajisjeve dhe materialeve	**Trafik dhe pluhur i shtuar.**	Përmirësimi i rrugës se hyrjes për ne shesh. Lagie e vazhdueshme e sheshit. Zvogëlim i numrit të mjeteve
Përgatitja e sheshit dhe aktivitete te përgjithshme ndërtimi	Zhurma nga pajisjet	Mirëmbajtje e rregullt e mjeteve Pajisje konform normativave Veprimtari pune vetëm ditën
Menaxhimi i dherave të ndotura	**Shqetësime te mundshme te shëndetit.**	**Dheu i ndotur do te ruhet ne mënyrë te sigurt nen zone te asfaltuara për te shmangur përhapjen e ndotësve.**
Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe inerte	Shqetësime te mundshme te shëndetit	Fraksionimi i mbetuinave urbane dhe me pas largimi i tyre
Fuqia punëtore në veprim	**Fluksi i punëtorëve krijon trysni mbi banesat dhe trafikun**	**Fluksi i punëtorëve do të jetë i ulët dhe pjesa dërmuese e tyre do të jetojë në Fier**
Furnizimi me ujë te pijshëm.	Përkeqësim furnizimin me ujë të komunitetit	Përdorimi i ujit industrial nga burime të ndryshme nga ujësjellësi
Përfundimi i punimeve	**Pamja estetike**	**Nivelim dhe gjelbërim i sipërfaqeve të lira të sheshit si dhe të sheshit përqark**
Traseja e grupit të	Ndikim ne trafikun	Ulja e shpejtësisë

grumbullimit të naftës, Nr. 11	rrugor	Kompletimi me sinjalistikë rrugore
Gërmimi (zona e hedhjes)	Shpërndarja e sedimenteve pezull (cilësia e ujit dhe efektet e tërthorta ne jetën detare)	Ekspozim i detajuar i metodës dhe i programit te gërmimit do te përgatitet nga kontraktuesi sipas direktivave te Bankës Botërore për ndërtimet pranë bregdetore
Pajisjet e tokës	Zhurma	Menaxhimi me i mire i kushteve specifike te kontratës se kantierit te ndertimit. Paraqitja e një Plan Menaxhimi Mjedisor nga kontraktori i ndërtimit qe do te aprovohet nga BPA dhe do te monitorohet nga personeli supervizues.
	Ndotja e ajrit (pluhurat,tymrat)	
Gërmuesit	Ndotja e ujit (pajisjet detare)	
Te gjithë punët e ndërtimit	Mbetuninat	

Masat zbutëse për ndërtimin dhe fazat operacionale janë përmbledhur ne tabelën 2. Kjo tabelë identifikon masat zbutëse qe duhen te implementohen për te minimizuar efektin e parashikuar te secilit aktivitet. Te gjitha çështjet e planit zbutës duhet te konsiderohen si praktika te mira inxhinierike dhe praktikat me te mira te menaxhimit. Masat për uljen dhe kontrollin e çlirimeve gjate fazës se operimit janë përshkruar ne tabelën e mëposhtme. Këto përfshijnë:

- Minimizimin e ngarkesës;
- Përmbajtjen;
- Rikuperimin/Riciklimin;
- Pakësimin e çlirimeve;
- Trajtimin dhe largimin e mbeturinave.

Masat zbutëse për periudhën e shfrytëzimit të grupit të grumbullimit te naftes

Aktiviteti	Ndikimet mundshme	Masat zbutëse
Pajisjet e ngarkim-shkarkimit	Çlirimet VOC	Rikuperimi i avujve të benzinës dhe te gazoilit nga autocisternat, vagon cisternat dhe rezervuarët dhe dërgimi i tyre tek njësia e rikuperimit sipas standardeve te B.E
Lëvizjet e kamionëve për ngarkimin e nënprodukteve te	Trafiku	Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët (natën mundësisht)
	Çlirimet e tymrave dhe blozës se	Parashikimi i një grafiku lëvizjesh në orët e qarkullimit të pakët (natën mundësisht)

naftës dhe LPG	djegieve	
Derdhjet e rastit nga depozitat e naftës bruto	Ndotja e mundshme e ujit	Shtrimi me beton i baseneve te mjitjes do te lejoje mbledhjen efektive te derdhjes. Grumbullimi i derdhjeve të rastit në pusetat përkatëse dhe trajtimi i tyre sipas normave të parashikuara në projekt. Uji i ndotur me vaj do te trajtohet para se te derdhet ne mjedis
Menaxhimi i mbeturinave te lëngshme	**Ndotja e mundshme e mjedisit**	**Nafta/shkuma e nxjerre nga ndarësi ujë/nafte dhe nga njësia e flokulimit do te riciklohet ose po te jete e nevojshme do te depozitohet dhe do ti nënshtrohet periodikisht trajtimit te përhershëm para se te derdhet.**
Menaxhimi i mbeturinave te ngurta	Ndotja e mundshme e mjedisit	Tipat, sasitë,data dhe mënyra e largimit te gjithë mbeturinave te rëndësishme do të regjistrohen dhe do të bëhen sipas tabelës 6.1

Planet e sigurisë dhe të menaxhimit të katastrofave hipotetike

Rehabilimi i Grupit të grumbullimit të naftës, te nënprodukteve te naftës do të shënojë një faqe të re në historinë e mjeidsit të në Shqipëri. Megjithatë duhet pasur parasysh edhe se: Qarkullimi i përgjithshëm i naftës dhe nënprodukteve të saj në nivel botëror kalon shifrën e 3*106 metrik ton nga të cilat mbi 15 % e tyre janë objekt i aksidenteve të mundshëm; Kur nafta apo nënprodhimet e saj ndotin aksidentalisht detin, duhen bërë përpjekje urgjente për largimin e saj nga uji mbasi shpërndarja e saj shoqërohet me pasoja katastrofike;

Shpërndarja e njollave ndotëse të naftës në det varet nga një mori faktorësh si ; vetitë fiziko kimike te naftës, kushtet metereologjike dhe klimatike, vendi ku ndodh aksidenti etj.; Parashikimi i shpërndarjes së njollave ndotëse të naftës mund të bëhet sipas një modeli matematiko-fizik që merr në konsideratë faktorët e mësipërm; Ndryshimi i kushteve meteorologjike mund të kërkojë ndryshimin e masave dhe mjeteve ndërhyrëse për të mënjanuar ndikimet negative;

Derdhjet e nënprodukteve te naftës ne steré thuajse përherë kane çuar ne ndotjen serioze te ujerave sipërfaqësore dhe veçanërisht atyre nëntokësore.

Për gjithë këto arsye del më se e domosdoshme edhe hartimi i një plani sigurie dhe ndërhyrjeje në rastet e padëshiruara por realisht ta pashmangshme. Kështu, Operatori BPA edhe Kalandra Konstruksion.Sh.p.k në bashkëpunim me njësitë e tjera operative lokale në zonë do të përgatisin planet e caktuar të sigurisë që do të do të jenë si pjesë përbërëse e projektit të propozuar. Këto plane që rekomandohen të bëhen nga ky studim, duhet të përfshijnë sa më poshtë: Përmbledhje e identifikimit të rreziqeve

Nr.	Kategorizimi i Aksidenteve	Specifike te skenës
1	Përplasje ne transportin tokësor	Autobote Vagonë-Cisterna Makineri te renda Makina te vogla
2	Zjarr/Shpërthim	Zjarr në rezervuare Zjarr në mjete transporti
3	Rrjedhje	Rezervuarët Autobote, Vagon-cisterna Tubacionet
4	Defekte strukturore	Tanker Hapësirat e makinerive
5	Mot i keq	Tajfune Cunami

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri në transportimin e naftes bruto do te realizohet sipas normave ligjore të Republikës së Shqipërisë, Evropës dhe normave e rregullave nga praktika teknike.

Paraqitja e masave për mbrojtje nga zjarri

Mbrojtja nga zjarri është projektuar si instalim statik/fiks dhe do të lidhet në sistemin e hidrantit, i cili furnizohet me ujë nga depoja e ujit për zjarr-fikje. Kapacitetin dhe presionin në rrjetin e hidrantit e sigurojnë pompat të vendosura në stacionin e pompave.

Në sistemin e mbrojtjes nga zjarri janë parashikuar këto masa teknike për mbrojtje nga zjarri:

Furnizimi me ujë për nevojat e mbrojtjes nga zjarri

Rrjeti i jashtëm i hidrantit me hidrantët mbitokësore dhe ormanët për hidrant

Pajisjet statike për mbrojtje nga zjarri në çdo objekt

Aparatet për zjarr-fikje Sistemi i alarmit të zjarrit (centrali) dhe lajmëruesit/detektorët në pika të ndryshme të depozitës, si dhe kamerat në rezervuarët, mbushëset e boteve dhe të autoboteve Butonat e alarmit në raste emergjente

Pajisjet mobile për zjarr-fikje

Mjetet për zjarr-fikje u mundësohet hyrja në terminal dhe çdo objekti në terminal nga dy drejtime

Furnizimi me ujë për mbrojtjen nga zjarri

Stacioni i pompave të ujit për zjarr-fikje furnizohen nga depozitat e ujit për zjarr-fikje. Gypi shtytës nga pompat është i lidhur në rrjetin e hidrantit. Rezervuari i ujit për zjarr- fikje furnizohet nga pusi. Niveli mbahet me galixhant. Në rrjetin e hidrantit është lidhur instalimi për ftohjen e objekteve si dhe dozatorët e shkumës me instalime për shpërndarjen e përzierjes për shuarjen e zjarrit në objektet perkatese.

Në zonat e rrezikshme nuk lejohet:

- Mbajtja dhe përdorimi i aparateve që shkaktojnë shkëndija , apo çlirojnë nxehtësi,
- Pirja e duhanit dhe përdorimin e zjarrit të hapur në çfarëdo forme,
- Mbajtja e sendeve që oksidojnë apo vetëndizen,
- Disponimi i sendeve që digjen apo që nuk i takojnë procesit teknologjik,
- Futja e mjeteve lëvizëse që gjatë punës mund të shkaktojnë shkëndija,
- Përdorimi i veshjeve/rrobave që mund të elektrolizohen (p.sh. rrobat sintetike apo veshjet pa mbrojtje antistatike, etj.). Zona 2 bënë përjashtim nga kjo në qoftë se nuk rregullohet ndryshe,
- Përdorimi i pajimeve dhe aparateve të cilat nuk janë të mbrojtur siç duhet nga elektriciteti statik, kur ato kanë rrezik të ngarkimit me tension elektrostatik.

Rruget e rehabilitimit te mjedisit

Uji i ndotur

Uji i përdorur për qëllime sanitare apo industriale shpeshherë ndotet për shkak të suspensioneve, kripërave, mbingopjes me ushqyes, baktereve apo pakësimit të oksigjenit të tretur në të.

Uji i ndotur sanitar

Ky ujë del nga tualetet, kuzhinat, banjat, lavanderitë dhe pastrimi i banesave. Këta ujëra mblidhen në kolektorë të posaçëm dhe përmes sistemit të kanalizimeve duhet të dërgohen në impiantet e trajtimit. Sasia e ujit sanitar të ndotur është rreth 70-90% e totalit që dërgohet te konsumatorët.

Përbërja e ujërave sanitarë të ndotur (ujërave të zeza)

Uji sanitar i ndotur përbëhet nga 99% ujë dhe vetëm 1% përbërësish të tjerë. Këtu hyjnë kryesisht BOD (lëndë që kërkojnë-konsumojnë oksigjenin), sedimente të tretur, sedimente në trajtë suspensioni, azot dhe fosfor. Ata përfaqësojnë një mjedis ideal për shumë mikroorganizma, bakter, kërpudha, viruse, dhe protozoar. Shumica e këtyre organizmave janë të parrezikshëm, ndërsa disa të tjerë janë të rrezikshëm dhe përhapës të sëmundjeve infektive. Ata shkaktojnë sëmundje si kolera, tuberkulozi, tifoja, sëmundje virusale etj. Skematikisht përbërja e tyre paraqitet në figurën 5.

Materialet e ngurta mund të jenë të tretura në ujë ose të patretura në të. Ata mund të jenë me natyrë organike ose inorganike. Suspensionet e ngurta apo ato të avullueshme luajnë rol në jetën e organizmave të gjallë. Materiali organik përbëhet nga proteina dhe karbohidrate.

Uji i ndotur industrial

Uji i ndotur i derdhur nga sektori industrial përfshin ujin sanitar, ujin e derdhur nga proceset teknologjike, ujin e përdorur për ftohje dhe atë të përdorur për ngrohje. Në dallim nga ujërat e zeza të ardhura nga komunitetit, uji industrial ka karakteristika të

veçanta. Këto ujëra kanë BOD të lartë dhe mbetjet kanë natyrë inorganike dhe toksike.

Karakteristikat e njollave të trajtuara dhe të patrajtuara të naftës

Karakteristikat e njollave të naftës varen nga shumë faktorë, duke filluar nga tipi dhe vetitë e naftës së derdhur, kushtet klimatike, niveli i baticave dhe shumëllojshmëria e jetës së gjallë në zonën e ndotur. Edhe pse çdo njollë nafte ka vetitë e saj, nuk bëhet ndonjë gabim shumë i madh duke bërë një përgjithësim të rezultateve të arritura me njollat e naftës të trajtuar me dispergantë, apo të pastruara mekanikisht, kudo që të jenë bërë këto procese. Drejtimi i lëvizjes dhe përhapja e njollave të naftës, është një proces fizik tërësisht i interpretuar nga pikëpamja shkencore. Shpejtësia e përhapjes së njollës së naftës është afërisht sa 3.5÷4.5% e shpejtësisë mesatare të erës. Një tjetër faktor që kushtëzon shpejtësinë e përhapjes së saj është edhe niveli i baticave në zonën e ndotur. Vektori i përhapjes së njollës së naftës është vektori rezultant i këtyre dy vektorëve. Edhe pse në disa raste është përdorur korrektimi Coriolis (efekti Coriolis-shmangia e dukshme e një objekti lëvizës, të përfshirë në një lëvizje rrotulluese, i shkaktuar nga rrotullimi i tokës dhe inercia e masës në lëvizje), rezultatet praktike kanë treguar se nuk ka qenë i nevojshëm. Këto llogaritje aplikohen duke vendosur origjinën e koordinatave në qendrën e njollës së naftës, një përafrim që është shumë i saktë për periudhën fillestare të krijimit të saj, por përherë e më i pasaktë në periudhën e mëpasme, kur njolla copëzohet (dispergohet).

Procedura normale në këtë rast është trajtimi i çdo njollëze si njësi më vete. Përhapja e njollës së naftës kushtëzohet gjithashtu edhe nga forcat gravitative si edhe tensioni sipërfaqësor i naftës. Procesi i përhapjes së njollës së naftës shoqërohet me shumë procese të tjera, avullimi i naftës, tretja e fraksioneve të lehta të saj, krijimi i emulsioneve, oksidimi si edhe degradimi bakterial. Shpejtësia dhe niveli i avullimit varet nga përbërja e naftës, era dhe kushtet e valëzimit detar dhe shpejtësia e tretjes. Avullimi i fraksioneve më të lehta të naftës, C6 e poshtë ndodh brenda 2÷3 orëve të para, ndërsa brenda 24 orëshit të parë avullojnë fraksionet më të rënda deri te C12, C14. Procesi i avullimit dhe tretjes së fraksioneve të naftës shoqërohet me krijimin e emulsioneve. Ky proces ndihmohet nga përzierësit e shtuar në naftë apo edhe shndërrimet kimike që shoqërojnë degradimin bakterial të saj. Megjithëse emulsionet krijohen më ngadalë se procesi i avullimit dhe tretjes së fraksioneve të naftës, duke qenë se ndryshon natyrën e njollës, është një problem serioz.

Krijimi i emulsioneve ndihmohet edhe nga shpejtësia e erës dhe valëzimi si edhe ndryshimi i shpejtësisë me të cilën lëviz uji, nga ajo me të cilës lëviz nafta. Ky ndryshim është afërsisht sa 1% e shpejtësisë së erës. Procesi i oksidimit të njollës së naftës dhe mekanizimi i tij, ende nuk është kuptuar dhe interpretuar si duhet. Sedimentet e ngurta, përgjithësisht nuk luajnë thuajse asnjë rol në përhapjen e njollës së naftës. Në

tabelën 5 mund të shihet se si mund të ndikohet një njollë nafte nga trajtimi i saj me dispergantë.

Vetitë fiziko – kimike te naftës ne kushte sipërfaqësore

Mbështetur ne analizat e kryera për puse te veçanta shikohet se densiteti i naftës luhatet ne një diapazon te gjere nga 0.860 – 0.980 gr/cm3. Densiteti i naftës i brezit naftëmbajtës fillestar ka rezultuar ne vlera 0.910 gr/cm3 qe i takon pjesës se sipërme te brezit naftëmbajtës. Gjate shfrytëzimit u vërejt rritje graduale e densitetit te naftës dhe ne momentin e shfaqjes se ujit densiteti arriti vlera e 0.930 – 0.935 gr/cm3. Vlerat e ulëta te densitetit janë si rrjedhoje e pranisë se kondensatit ne nafte. Vlera me te larta te densitetit 0.980 gr/cm3 janë kapur ne zonën jugore qe mendojmë se lidhen me mbylljen e kurthit ne këtë drejtim. Aktualisht densiteti i naftës ne puset me ujë (emulsioni) rezulton ne vlera te larta 0.930 – 0.985 gr/cm3 qe vjen si rezultat i përmbajtjes se ujit ne fluid. Duke pasur parasysh qe densiteti i naftës ne puset pa ujë vjen me kohen ne rritje si dhe densitetin e naftës ne brezin fillestar 0.910 – 0.935 gr/cm3, vlerën mesatare te densitetit te naftës pranohet të jetë rreth 0.920 gr/cm3. Përmbajtja e squfurit luhatet ne vlera nga 1.5 – 9.69 % me vlere mesatare rreth 3%.Me kohen temperatura e fillimit te vlimit rritet kurse produktet e bardha janë ulur.

Vetitë e gazit shoqërues te naftës

Densiteti është luhatur ne vlere 0.708 – 0.720 gr/l. Ky gaz ka qene i pasur me lende johidrokarbure si H2S = 2 – 3.5 %, CO2 = 7 - 8 % e N2 = 1 - 2 %. Densiteti i gazit shoqërues te naftës ka qene me i rritur 0.72 – 0.78 gr/l dhe përmbajtja e lendeve johidrokarbure relativisht me e larte H2S = 2 - 4 %, CO2 = 7 - 12%, N2 = 2%. Aktualisht nga nxjerrja ne kohe dhe kur ne vendburim është krijuar një gjendje e përzier e gazeve, rezulton se përmbajtja e H2S është rritur pothuajse ne te gjithë puset nga 3% ne 7% dhe CO2 nga 6% ne 7,5%. Kjo ka bere qe sasia e metanit te ulet nga rreth 80% ne 70% .

Vetitë e ujit shtresor

Uji shtresor është me mineralizim te përgjithshëm 71200 mg/l ndërsa kloruret 40000 mgr/l. Shfrytëzimi i vendburimit shfaqi ne shume puse deri dhe ne kulme te strukturës ujë te lire. Nga te dhënat duket se kloruret luhaten 11000 - 50000 mg/l dhe mineralizimi i përgjithshëm luhatet 28000 - 93000 mg/l. Densiteti i ujërave varion nga 1.02 gr/cm3 ne 1.05 gr/cm3. Tipi i ujërave është klor - kalcit me mineralizim te larte. Në mënyrë më të detajuar vetitë e ujit të nxjerrë nga vendburimi dhe vendet e marrjes së kampioneve paraqiten në tabelat në vijim.

KONKLUZIONE DHE PERFUNDIME

Konkluzione

Në përfundim ne gjykojmë që zhvillime të vazhdueshme në këtë zonë mund të jenë rezultat i faktorëve qendrorë dhe lokal: duhet të sigurohet bashkë-ekzistenca midis degëve të ndryshme të ekonomisë duke krijuar lidhje logjike dhe sinergji.
Është e nevojshme të garantohet mbrojtje dhe përmirësim i kapacitetit prodhues të burimeve natyrore pa shkatërruar ciklin ekologjik dhe balancat natyrore, duke ndikuar në reduktimin e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave pa ndotur ambientin dhe komunitetin rural, dhe reduktimin e shkatërrimit te sektorit bujqësorë nga faktorë natyrore dhe social-ekonomik.
Pjesëmarrja e fermerëve në bordin e skemave mbështetëse, rritja sasiore dhe numrit të shërbimeve, duke perfshirë këtu edhe skemat mbështetëse për industrinë e ushqimeve bujqësore dhe mjeteve logjistike për tregëtine e produkteve bujqësore do të permirësoj dukshëm ndërhyrjen dhe eficencën e tyre.
Aty ku është e mundur duhen koordinuar iniciativat e qeverisë lokale me atë qendrore dhe duhen mbështetur skemat me iniciativat e donatorëve ndërkombëtarë dhe kompanive të naftës që veprojnë në rajon. Duhet të shmanget mbivendosja e aktiviteteve dhe të mbahen burimet e nevojshme per të zbatuar keto projekte të rëndësishme.
Nga eksperienca jonë si rezultat i skemës mbështetëse në mbjelljen e ullinjve, sipërfaqja e mbjellë me bimën e ullirit u rrit 20%-25% në krahasim me vitin 1992, ndërsa numri i rrënjëve të kësaj bime pati një rritje shumë herë më të shpejtë (rreth 40% më shumë). Sipërfaqja e re e mbjellë me ullinj në Patos për 20 vjet është rritur me 147 ha, ndërsa në Portez me 160 ha dhe në Ruzhdie janë mbjell 26000 rrënjë të reja ndërkohë që në 1990 ekzistonin vetëm 38000 rrënjë ulliri.
Zona e studimit t paraqet nje zhvillim intesiv te industrise se hidrokarbure e harmonizuar me zhvillimet e tjera ekonomike, sociale dhe kulturore , qe natyrshem shoqerohen me ndikime positive dhe negative si ne mjedisin natyror , social dhe ate ekonomik , ndikime keto karakteristike per veprimtarit e ketij lloji
Ndikimet negative te mundshme te vleresuara jane plotesisht te menaxhueshme , nga ana e kompanive qe kane lidhur Marreveshje te Hidrokarbureve qe i shkaktojne ato , dhe te kontrollueshme nga organet dhe institucionet perkatese te kontrollit .
Vetmonitorimi i emetimeve te cdo lloj aktiviteti nga kompania perkatese, ne cdo fazete operimitderi ne mbyllje te saj , eshte mase jo vetem parandaluese por dhe kontrolluese e gjendjes mjedisore te rajonit
Per cdo parameter me impakt te konsiderueshem negative ne mjedisin natyror dhe ate social , rekomandohen masa te forta rreptesisht te zbatueshme ne menyre qe te mos kalohet

niveli limit i emetimeve brenda normave te lejuara sipas legjislacionit shqipetar dhe atij te BE.

Zhvillimi i rajonit te projektit eshte plotesisht i mundshem dhe ne harmoni me subjektet qe operojne aktualisht apo do te operojne ne te ardhmen ,dhe me te gjithe aktoret e tjere te ndikuar nga keto zhvillime , nese per cdo subject dhe ne cdo hallke te veprimtarise se tij operuese zbatohen rreptesisht kondicionet ligjore sipas llojit te aktivitetit dhe veprimtarise ne cdo hallke dhe ne cdo stad te zhvillimit , kondicione te cilat parandalojne, apo reduktojne demtimet e mjedisit natyror dhe atij social - kulturor .

Moszbatimi i kritereve ligjore perkatese ngarkon me penalitete dhe pergjegjesi subjektet qe shkelin kushtet te vendosura ne lejet perkatese mjedisore.

Përfundime

Nafta, gazi natyror, dhe hidrokarburet e tjera përbëjnë një pasuri kombëtare të rëndësishme dhe të papërtëritshme. Zhvillimi i metejshem I industrise se hidrokarbureve ne rajonin e projektit, krahas zhvillimeve te tjera ekonomike dhe sociale qe tashme zhvillohen ne kete zone, ka përparësi qe favorizohen së pari nga burimet nëntokësore, kjo pasuri e pacmuar, dhuratë e natyrës,qe gjenden në këtë rajon, tashmë padyshim tëvlerësuara nga disa studime të kryera, dhe zhvillimeve paralele të aktiviteteve të ngjashme përreth zonës së projektit apo në afërsi të saj .

Arsyet kryesore te zhvillimi te projektit te shfrytezimit te vendburimit të naftës ne këtë rajon janë:

- Ulja e nevojes se vendit per importim hidrokaruburesh.
- Kriza ne rritje e tregut boteror per hidrokarbure dhe rritja e vazhdueshme ecmimeve të saj.
- Rritjen e ekonomisë së vendit , duke përbërë kontributin kryesor në bilancin energjetik të tij.
- Pakesimi i rezervave natyrore energjitike vecanerisht i atyre hidrokarbure ne rang global.
- Nevoja gjithnje ne rritje e ekonomise per lende djegese.
- Rritje e kapaciteteve eksportuese të vendit ndaj "arit të zi " duke sjelle jo vetem fitime ekonomike por duke e parë ate edhe si një vend strategjik rajonal dhe me gjerë
- Tradita e zhvillimi të aktiviteteve të ketij lloji ne rajon për rreth 80 vite.
- Nje faktor pozitiv I shfrytezimit te burimeve natyrore eshte qe kjo dege paraqet nje konkurence te qendrueshme, per arsye sepse nuk mund te transferohet diku. Ne kete dege, ndikimi pozitiv nuk perfshin vetem ekonomine e vendit por eshte dhe nje mundesi qe i jep vendit per investime shume te medhaja te huaja (per shkak te karakterit te investimit), per te ardhura me te mira per punetoret, rritja e mundesise per eksportim, perfitimet qe ka shteti nga tatimet e ndryshme etj. Gjithashtu rol te rendesishem luan edhe ne forcimin

gjeopolitik te vendit, sepse burimet natyrore jane te kufizuara gjeografikisht. Kjo eshte me teper per hidrokarburet, per rolin qe luajne keto burime natyrore per perfitimin e energjise e cila eshte nje problem global.

- Do te ndikoj pozitivisht tek ekonomia e zones, ne infrastrukturen e saj duke realizuar ndertime te reja ne rrjetin rrugor, mundesi punesimi per banoret e zones dhe ngritjen e organizmave ndihmes qe do te nevojiten, pergatitja e specialisteve per procese te ndryshme te shfrytezimit, te cilet do te jene te afte per te punuar edhe jashte vendit me eksperiencen e perfituar, nderlidhja qe do te kete kjo dege me dege te tjera te veprimtarive te ndryshme dhe qe u jep dhe atyre mundesine e zhvillimit
- Perfitimet qe vijne nga kjo dege e industrise jane me te medhaja se sa nga perfitimet qe vijne nga dega e tjera te teknologjise. Duke e pare kete dege te industrise ne kete kendveshtrim vete shteti duhet te krijoje nje politike te mire mbeshtetese per te siguruar perfitimet maksimale ekonomike dhe shoqerore nga veprimtaria e kerkimit dhe shfrytezimit te zonave nafte mbajtese.
- Mundesite qe duhen te jepen nga organizmat shteteror per lehtesimin e fuksionimit te ketyre veprimtarive jane:
- Dhenia e hapsires ligjore, per inkurajimin dhe nxitjen e personave juridike per shfrytezimin e hidrokarbureve, por jo me pajtime per ndikimet qe mund te shkaktohen ne mjedis dhe ne shoqeri.
- Investimi i perfitimeve nga tatimet mbi subjektin qe shfrytezon keto burime dhe te atyre mbi te ardhurave, ne dege te ndryshme te shoqerise, per ndertime te ndryshme, per investime ne mjedis dhe per zbatimin e teknikave me te mira per shfryezimin e hidrokarbureve.
- Ndarja e perfitimeve ne menyre sa me te drejte: d.m.th. mbeshtetje ekonomike te shoqerise qe jeton ne ato zona ku ndodh shfrytezimi dhe qe mund te kete ndikim ne jeten e tyre dhe per te ndihmuar shtresat me ardhura te ulta.

Lidhur sa më sipër po japim disa argumenta më konkrete :

Shfrytezimi i hidrokarbureve dhe e zhvillimi i metejshem i kesaj industrie ne rajonin e projektit ka nje rendesi te madhe per zhvillimin ekonomik te zones dhe ne fuqizimin e ekonomise kombetare duke kontribuar me tatimet ne shtet, mundesia per vende te reja pune dhe ne rritjen ekonomike-sociale te zones. Perfitimet ekonomike dhe vendet e lira te punes nuk jane vetem ne dobi te punesuarve ne degen e shfrytezimit te hidrokarbureve por ne teresine e ekonomise.

Lidhjet ekonomike te nje veprimtarie te shfrytezimit të hidrokarbureve me faktorët e tjerë janë (Eggert,2001):

- "Lidhja me faktore dytesore" (backëard linkage): ka lidhje p.sh. ne blerjen e produkteve ushqimore, ne konsumimin e energjise elektrike, me perdorimin e sherbimit te transportit,

nevoja per lende te pare te mara nga tregu I zones perreth.

- "Lidhja ne te ardhmen" (forëard linkage): ka lidhje me procesin e fundit te nxjerrjes se hidrokarbureve qe eshte perpunimi i naftes nga dege te tjera sic jane, rafinerite.
- "Lidhje te mundshme" (final demand linkage): ka lidhje me mundesine qe jep ky subjekt per investime apo per sherbime te vogla qe mund te realizojne familjet e te punesuarve per nevojat e tij.
- "Lidhja me ekonomine e vendit " (fiscal linkage): Ka lidhje me detyrimet tatimore te subjektit ne lidhje me shtetin. Keto perfitime nga investime te tilla shfrytezohen per qellime te tjera sic jane ndertime shkollash, qendra shendetesore apo ne infrastrukture etj.
- Lidhjet ndermjet ekonomise dhe investimit te shfrytezimit te hidrokarbureve me zone ku kryhet shfrytezimi karakterizohen ne:
- Ne lidhje indirekte te cilat vleresojne ndikimin e veprimtarise se shfrytezimit te hidrokarbureve ne mundesine e punesimit, ne te ardhurat e banoreve te kesaj zone dhe ne vleresimin perfundimtar te perfitimit ekonomik.
- Lidhje perfitimi te detyruara te cilat vlersojne ndikimin e te ardhurave te perfituara nga kjo veprimtari ne menyre te drejteperdrejte apo indirekte ne rritjen e nivelit ekonomik te zones.

Mbetjet e rrezikshme grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme vetëm kur ato janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me ligjet ne fuqi. Subjekti transportues dhe marrës në dorëzim i dërgon çdo 3 muaj Agjencisë Kombëtare të

Mjedisit informacion për dorëzimin e mbetjeve.
Subjekti "ALBPETROL"Sh.A. qe grumbullon / transporton mbetje, dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat perktese konform kerkesave ligjore..
Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

Dokumenti i transferimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transferuesit;
c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të personit, tek i cili transferohet mbetja (pritësi);
d) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen dhe tipin e konteinerëve në të cilët ndodhet;
e) vendin, kohën dhe datën e transferimit;
f) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme/rezikshme bashkë me listën e kodeve respektive;
g) hollësi për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet jo të rrezikshme/rrezikshme kanë pësuar deri në këtë çast.